Kosova

Raport Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2023

AMMK

Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit

2023

Shtator, 2024
Prishtinë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS	**KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU ŽIVOTNE SREDINE**	**KOSOVO AGENCY FOR ENVIRONMENTAL PROTECTION**

AMMK

Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit 2023

Prishtinë,

Shtator 2024

Përmbajtja

1. Hyrje 9
2. Përmbledhje e të gjeturave kryesore të raportit **10**
3. Gjendja e mjedisit dhe trendi **13**
3.1. Ajri 13
3.1.1. Cilësia e ajrit 13
3.1.2. Emisionet në ajër 18
3.1.3. Emisionet e gazrave serrë (GHG) 20
3.2. Uji **22**
3.2.1. Cilësia e ujërave sipërfaqësore **22**
3.2.2. Sasia e ujërave sipërfaqësore **38**
3.2.3. Shfrytëzimi i resurseve ujore **39**
3.3. Toka/dheu **40**
3.3.1. Përdorimi i tokës në bujqësi **40**
3.3.2. Monitorimi i tokave **41**
3.3.3. Ndotja e tokave **42**
3.4. Menaxhimi i mbeturinave **43**
3.4.1. Gjenerimi i mbeturinave komunale **47**
3.4.2. Analiza e përbërjes së mbeturinave komunale **50**
3.4.3. Deponimi i mbeturinave komunale në deponi sanitare **51**
3.4.4. Trajtimi i mbeturinave **53**
3.4.6. Mbeturinat spitalore **56**
3.4.7. Mbeturinat industriale **58**
3.4.8. Importi dhe eksporti i thasëve dhe qeseve të plastikës si dhe i mbetjeve **59**
3.5. Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit **61**
3.5.1. Zonat e mbrojtura **61**
3.5.2. Biodiversiteti **63**
3.5.3. Gjendja e resurseve pyjore **65**
4. Ndikimet mjedisore në shëndetin publik **67**
5. Gjendja e mjediseve të rrezikuara **69**
5.1. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të KEK-ut **69**
5.2. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të Feronikelit **71**
5.3. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të Sharrcem **74**
6. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit **77**
6.1. Zbatimi i strategjive dhe planeve mjedisore 77
6.2. Inspektimi dhe kontrolli i zbatimit të ligjit 79
6.3. Leje- dhënia 81
6.4. Zhvillimet dhe ngecjet institucionale 83
6.5. Investimet në mbrojtjen e mjedisit 84
7. Rekomandimet **89**
8. Referencat **93**
9. Shtojcat **95**

Lista e shkurtesave

3R	Reduktimi, ripërdorimi dhe riciklimi
AKS1	Aglomeracioni i Kosovës 1
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
APK	Agjencia e Pyjeve të Kosovës
AQI	Air Quality Index (Indeksi i Cilësis së Ajrit)
ICA	Indeksi i cilësisë se Ajrit
ARRU	Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BB	Banka Botërore.
BE	Bashkimi Europian
ITUN	Impianti i trajtimit të ujërave të ndotur
NO2	Dioksidi i azotit
O3	Ozoni
VKE	Vlera kufitare e emisioneve
SO2	Dioksidi i squfurit
EIONET	Rrjetit Europian për Monitorim dhe Vëzhgim.
NOx	Oksidet e azotit
EQ	Equivalent
ESS L.L.C	Environmental Sustainable Solution
CO2	Dioksidi I karbonit
FSK	Forcat e Sigurisë së Kosovës
PM	Grimcat
GHG	Gazra serrë
GIZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
H	Niveli
IHMK	Instituti Hidrometeorologjikë i Kosovës
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IPA	Instrumenti i Para anëtarësimit i BE-së
IUCN	Unioni Ndërkombëtar i Konservimit të Natyrës
IWRM-K	Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë
JICA	Agjencia Ndërkombëtare Japoneze për Zhvillim
KE	Këshilli Evropian
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Kosovo Forces
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
KPMMK	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në Kosovë
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave.
KRU	Kompania e Ujësjellësve Rajonal
LM	Leje Mjedisore
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MN	Monument i Natyrës.
MNRV	Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

MTS	Materiet Totale të Suspenduara
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
PK	Park Kombëtar
PKMM	Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLVM	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
PMK	Programi Mjedisor i Kosovës
PT	Pluhuri Total
Q	Prurje
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
RM	Rezervat Natyrore
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
SKZH	Strategjinë Kombëtare për Zhvillim
SNK	Strategjia për Ndryshime Klimatike
SHBO	Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit
SHKO	Shpenzimi Kimik i Oksigjenit
TC	Termocentral
TCA	Termocentrali A
TCB	Termocentrali B
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
VML	Vlera Maksimale të Lejuara
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
ZKS1	Zonë Monitoruese Kosova 1

Lista e hartave

Harta 1:	Drejtimet e lëvizjes së erës
Harta 2:	Rrjeti i ujerave sipërfaqësore në Kosovë
Harta 3:	Shpërndarja e lokacioneve të stacioneve të monimotimit të cilësisë fiziko-kimike të ujërave nëntokësor
Harta 4:	Lokacionet e monitorimit biologjik në pellgun e lumit Ibër, Morava e Binçës dhe Lepenc
Harta 5:	Rrjeti Nacional Hidrometeorologjik i Kosovës
Harta 6:	Deponitë regjionale, komunale dhe stacionet e transferit
Harta 7:	Gjenerimi i mbeturinave sipas komunave 2022-2023

Lista e tabelave

Tabela 1: Të dhënat për cilësinë e ajrit sipas parametrave dhe stacioneve monitoruese në zonën aglomerate për vitin 2023
Tabela 2: Të dhënat për cilësinë e ajrit sipas parametrave dhe stacioneve monitoruese ZKS1 për vitin 2023
Tabela 3: Emisionet në ajër nga ndotësit kryesor sipas burimeve të emetimeve (ton/vit)
Tabela 4: Emetimet e gazrave serrë (Gg) nga sektori i Energjisë për vitin 2022
Tabela 5: Trendi i cilësisë së ujërave të lumenjve 2022-2023
Tabela 6: Statusi ekologjik i trupave ujorë në pellgun e lumit Ibër - diatomet
Tabela 7. Statusi ekologjik i trupave ujorë në pellgun e lumit Ibër - makroinvertebrorët
Tabela 8. Statusi ekologjik i trupave ujorë në pellgun e lumit Ibër – peshqit
Tabela 9: Statusi ekologjik i trupave ujorë në pellgun e lumit Morava e Binçës - diatomet
Tabela 10. Statusi ekologjik i trupave ujorë në pellgun e lumit Morava e Binçës - makroinvertebrorët
Tabela 11. Statusi ekologjik i trupave ujorë në pellgun e lumit Morava e Binçës - peshqit
Tabela 12: Statusi ekologjik i trupave ujorë në pellgun e lumit Lepenc - diatomet
Tabela 13. Statusi ekologjik i trupave ujorë në pellgun e lumit Lepenc - makroinvertebrorwt
Tabela 14. Statusi ekologjik i trupave ujorë në pellgun e lumit Lepenc - peshqit
Tabela 15: Vlerat mesatare vjetore të nivelit H (cm) sipas stacioneve matëse 2023
Tabela 16: Vlerat mesatare vjetore të prurjeve Q (m3/sec) sipas stacioneve matëse 2023
Tabela 17: Shfrytëzimi i ujit 2022-2023 nga ndërrmarrjet e mëdha industrial
Tabela 18: Trendi i përdorimit të tokës bujqësore 2018-2022 sipas kategorive
Tabela 19: Burimet e ndotjes së tokës
Tabela 20: Gjenerimi i mbeturinave komunale kg\banor\vit (2021, 2022 & 2023)
Tabela 21: Përbërja e mbeturinave
Tabela 22: Numri i deponive ilegale të identifikuara, viti 2022 dhe 2023 sipas komunave
Tabela 23: Sasia e mbeturinave spitalore të sterilizuara në 8 qendrat spitalore rajonale
Tabela 24: Importi i mbetjeve gjatë vitit 2023
Tabela 25: Eksporti i mbetjeve gjatë vitit 2023
Tabela 26: Numri dhe sipërfaqja e Zonave të Mbrojtura 2023
Tabela 27: Sipërfaqja pyjore sipas përbërjes dhe strukturës së grumbullit (ha)
Tabela 28: Prerjet në pyje me pronësi private dhe shoqërore për vitin 2023
Tabela 29: Numri i rasteve dhe incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në periudhën janar- dhjetor të vitit 2022 dhe 2023
Tabela 30: Disa nga treguesit kryesor të operimit të KEK-ut gjatë vitit 2023
Tabela 31: Mbeturinat metalike, vajra, shirit transportues
Tabela 32: Emisionet vjetore në ajër për ndotësit SO_2, NOx dhe pluhurin total nga `TCA` dhe `TCB` 2022-2023
Tabela 33: Përmbledhje e rezultateve vjetore të matura te pluhurit të emetuar nga Feronikeli për vitin 2023
Tabela 34: Sasia totale vjetore e ndotësve CO, NOx dhe SO_2 për vitin 2023 nga Feronikeli
Tabela 35: Gjenerimi i mbeturinave industriale nga Feronikeli për vitin 2023
Tabela 36: Gjenerimi i mbeturinave sipas kategorive nga Sharcem për vitin 2023
Tabela 37: Niveli i zbatimit të strategjive dhe planeve të veprimit për sektorin e mjedisit
Tabela 38: Planet mjedisore në nivel lokal 2023
Tabela 39: Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore 2020-2023

Tabela 40: Kallëzimet penale në prokuroritë themelore për dëmet në resurset natyrore në PK 2023
Tabela 41: Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore në nivel lokal 2023
Tabela 42: Aktivitetet për leje -dhënie gjatë vitit 2023
Tabela 43: Buxheti i MMPHI për 2021-2023
Tabela 44: Disa nga projektet kapitale mjedisore të mbështetura nga buxheti i MMPHI 2023
Tabela 45: Disa nga projektet me donatorë në sektorin e mjedisit dhe ujërave 2023

Lista e figurave

Figura 1: Parametrat e monitoruar në AKS 1
Figura 2: Parametrat e monitoruar në ZKS 1
Figura 3: Trendi i mesatareve vjetore të PM_{10} për vitet 2013-2023
Figura 4: Trendi i mesatareve vjetore të $PM_{2.5}$ për vitet 2013-2023
Figura 5: Trendi i mesatareve vjetore të O_3 për vitet 2013-2023
Figura 6: Trendi i mesatareve vjetore të SO_2 për vitet 2013-2023
Figura 7: Trendi i mesatareve vjetore të CO për vitet 2013-2023
Figura 8: Trendi i mesatareve vjetore të NO_2 për vitet 2013-2023
Figura 9: Trendi i emetimeve në ajër 2014-2022 (ton/vit)
Figura 10: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave të lumenjve-IHMK 2023 (Pellgu i Drinit të Bardhë)
Figura 11: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave të lumenjve-IHMK 2023 (Pellgu i Ibrit)
Figura 12: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave të lumenjve-IHMK 2023 (Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit)
Figura 13: Trendi nga monitorimi i cilësisë së ujërave të lumenjëve në Pellgun e Drinit të Bardhë për vitet: 2021, 2022 dhe 2023
Figura 14: Parametri nitrat nga monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësor-IHMK/MIRU 2023 (Pellgjet: Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci)
Figura 15: Parametri nitrit nga monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësor-IHMK/MIRU 2023 (Pellgjet: Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci)
Figura 16: Parametri amonium nga monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësor-IHMK/MIRU 2023 (Pellgjet: Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci)
Figura 17: Përbërja e mbeturinave në Kosovë
Figura 18: Deponimi i mbeturinave komunale në deponit sanitare në Kosovë, 2018-2023
Figura 19: Trendi i deponimit të mbeturinave komunale në Kosovë, 2018-2023
Figura 20: Trajtimi i mbeturinave komunale në Kosovë, 2022
Figura 21: Gjenerimi dhe trajtimi i mbeturinave industriale në Kosovë, 2022
Figura 22: Trendi i gjenerimit të mbeturinave industriale në Kosovë 2018-2022
Figura 23: Sasia e thasëve dhe qeseve të plastikës të importuar, 2018-2023
Figura 24: Sasia e thasëve dhe qeseve të plastikës të eksportuara, 2017-2022
Figura 25: Numri i llojeve bimore sipas kategorive të kërcënueshëmrisë
Figura 26: Klasat e përdorimit të tokës në Kosovë (% nga sipërfaqja totale e tokës)
Figura 27: Paraqitja e vlerës mesatare për aerosediment për muajt: qershor – tetor 2023
Figura 28: Trendi i emisioneve të NOx dhe SOx për vitet 2021-2023

1. Hyrje

Më qëllim të monitorimit të cilësisë dhe vetive të mjedisit dhe sigurimin e informacionit të duhur për administratën, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit bazuar në Ligjin e Mbrojtjes së Mjedisit[1], Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës ka përgatitur Raportin Vjetor për Gjendjen e Mjedisit për vitin 2023. Sipas nenit 25, të këtij ligji, Qeveria e Republikes së Kosovës me propozim të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, i'a paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Përmes punës profesionale gjatë përcaktimit të përmbajtjes, metodologjisë dhe mënyrës së përcjelljes të gjendjes së mjedisi, Raporti përmban të dhëna për gjendjen e përgjithshme të mjedisit në Kosovë, dhe specifikisht për sektorin e ajrit, tokës, ujit, llojllojshmërisë biologjike dhe ndryshimet klimatologjike. Të prezantuara dhe me paraqitje vizuele përfshihet gjendja e mjediseve të rrezikuara dhe ndikimi i ndotjes së mjedisit në shëndetin e popullatës. Zbatimi i projekteve, planeve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e institucioneve mjedisore si dhe financimin e sistemit për mbrojtjen e mjedisit nga buxheti i shtetit dhe donacionet janë pjesë e rëndësishme e përfshirë në këtë raport.

Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve qeveritare, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës është institucioni që harton këtë dokument. Ky raport vjetor përveç qe paraqet gjendjen e mjedisit për vitin 2023, avancon dhe krahason cilësinë e të dhënave për mjedisin në disa raste me një vit me herët e në raste me tre (3) vite paraprake.

Për hartimin e raportit, AMMK ka grumbulluar të dhëna mjedisore nga institucionet monitoruese, operatorët, ndërmarrjet e ndryshme, publikimet, raportet dhe nga burime tjera. Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në informata kualitative mjedisore, të prezantuara në këtë raport. Sfida me e madhe ka qenë raportimi i të dhënve te institucioneve tjera jashtë MMPHI dhe AMMK, duke përfshirë nivelin lokal dhe operatorët përkatës.

Qëllimi i raportit është informimi i institucioneve vendimmarrëse për gjendjen e mjedisit në Kosovë, dhe në bazë të të gjeturave dhe rekomandimeve të bëhet zhvillimi i politikave, hartimi dhe zbatimi i legjislacionit dhe planifikimeve e investimeve strategjike.

[1] *Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr. 03/L-025*

2. Përmbledhje e të gjeturave kryesore të raportit

Ajri - Të dhënat tregojnë se për parametrin PM10, mesatarja vjetore nuk ka tejkaluar vlerën kufitare prej 40 µg/m³ në asnjë nga stacionet monitoruese. Po ashtu, për parametrat e tjerë të monitoruar, nuk ka pasur tejkalime të vlerave kufitare të mesatares vjetore në të gjithë zonën Aglomerate. Megjithatë, numri i ditëve me tejkalime për parametrin PM10, sipas standardit prej 35 ditë në vit, tregon se vetëm një stacion monitorimi në zonën aglomerate-AKS1, konkretisht Prishtinë-Rilindje, ka regjistruar tejkalime (36 ditë), ndërsa në ZKS1 janë regjistruar tejkalime vetëm në stacionin matës në Gjilan (40 ditë). Viti 2023 ka një ulje të ndjeshme të vlerave krahasuar me vitin 2022 sidomos për parametrat PM 10 dhe PM 2.5. Sa i përket emetimeve në ajër, sipas vlerësimit të bazuar në konsumin e lëndëve djegëse, burimi kryesor i emetimeve për ndotësit NO2 dhe SO2 është prodhimi i energjisë dhe ngrohjes, ndërsa sa i përket ndotësve PM2.5, PM10, pluhurit total dhe Monoksidit të karbonit (CO), burimi kryesor i ndotjes është ai i djegieve të vogla, ku përfshihen burimet residenciale, institucionale dhe komerciale. Transporti është burimi i dytë i ndotjes për NO2 pas sektorit të prodhimit të energjisë, ndërsa industria prodhuese dhe e ndërtimit është sektori i dytë për ndotje me CO pas djegieve të vogla. Emetimet vjetore të gazrave serrë në Kosovë për vitin 2022, për sektorin e energjisë bazuar në bilancin e energjisë. Sektori i energjisë është burimi kryesor i emetimeve të gazrave serrë me pjesëmarrje prej rreth 86% të totalit te emetimeve. Në kuadër të sektorit te energjisë, burimet kryesore të emetimeve janë: industria energjetike, transporti, industria e prodhimit dhe ndërtimit dhe konsumi i energjisë për ngrohje në ndërtesa rezidencial, komerciale dhe institucionale. Në vitin 2022 janë emetuar 8879 Gg CO2 eq, që krahasuar me vitin paraprak emetimet kanë rënë për 344 Gg CO2 eq.. Gazi kryesor i emetuar nga sektori i energjisë është CO2 me 99%, ndërsa Metani (CH4) N2O përfaqësojnë vetëm 1% të emetimeve. Për uljen e emetimeve të GHG nga sektori i energjisë rekomandohet rritja e e kapaciteteve për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtritshme të energjisë, rritjen e numrit të veturave me karburante alternative dhe elektrike, ndërrimin e lëndëve djegëse për ngrohje, zgjerimin e sistemeve për ngrohje qendrore si dhe rritja e efiçencës së energjisë në ndërtesa.

Uji – Në Pellgu i Ibrit, respektivisht në pikat monitoruese në lumin Prishtevka/Bresje dhe Graqanka/Vragoli pothuajse në të gjithë parametrat tregohen vlera më të ngritura. Në Pellgun e Moravës së Binçës dhe Lepencit me 5 stacione monitorimi tregohet se ka ngritje të shpenzimit kimik të oksigjenit përgjatë rrjedhjes së lumenjve. Sipas rezultateve te monitorimit gjatë viti 2023 prezenca e sasisë së fosfori total/ mg/l P nga analizat e bëra tregojnë se sasia e fosforit në ujërat e lumenjve të Kosovës nuk paraqesin ndikim të shprehur në ujërat sipërfaqësore me çka mund të konstatojmë se ujërat sipërfaqësore në Kosovë nuk janë të rrezikuar me eutrofikim. Investime në menaxhimin e ujërave të ndotura dhe ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura ka treguar menjëherë rezultate në përmirësimin e cilësisë së ujërave në lumenjtë.

Në bazë të vlerësimit të statusit kimik të ujërave nëntokësore sipas standardeve të cilësisë së ujërave nëntokësore, tejkalime në vlerën standarde për parametrin nitrat

janë: lumenjtë Ibri dhe Morava e Binçës, parametri amonium ka tejkalime ne lumin Ibër, kurse parametri nitriti nuk ka tejkalime. Sa i përket statusit ekologjik në Pellgun e Lumit Ibër, Pellgun e Lumit Morava e Bincës dhe Pellgun e Lumit Lepenc, pjesa më e madhe e lokacioneve janë vlerësuar me status të varfër deri në të mirë sa i përket diatomeve, me status i varfër deri tek ai moderuar sa përket makroinvetebrorëve dhe me status të varfër deri në të mirë sa i përket peshqve.

Toka - Aktualisht Kosova nuk ka program dhe as monitorim të rregullt të cilësisë së dheut/tokës. Ky aktivitet kryhet kryesisht përmes projekteve dhe aktiviteteve periodike. Sipas analizave të trendit të mbulueshmërisë së tokës është konstatuar se ndërrimi i destinimit të tokave mbetet një nga sfidat kryesore mjedisore në sektorin e tokës. Bujqësia, konsiderohet si një nga burimet kryesore të ndotjes së tokës bujqësore, që vije si rezultat i përdorimit të plehrave kimike dhe kimikateve tjera për trajtimin e tokës . Po ashtu edhe deponitë sanitare dhe ilegale të mbeturinave, industritë aktive dhe ato të vjetra, janë burim potencial i ndotjes së tokave për shkak të gjenerimit të mbetjeve industriale dhe përdorimit të kimikateve, që në disa raste ruhen në vende të pasigurta.

Menaxhimi i Mbeturinave - Kosova vazhdon të ballafaqohet me mungesë të menaxhimit efikas të mbeturinave. Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori është vlerësuar të jetë 235 kg/banorë/vit. Aktualisht në nivel nacional grumbullohen rreth 90% të mbeturinave të gjeneruara. Pjesa më e madhe e tyre deponohen në deponi sanitare, ndërsa ende nuk ka sistem të organizuar të ndarjes së mbeturinave në burim si dhe riciklim të mbeturinave. Në vitin 2023 shënohet një rritje e deponimit të mbeturinave më shumë krahasuar me vitin paraprak 2022. Menaxhimi i deponive sanitare të Kosovës nuk është i mirë dhe ndër problemet kryesore janë mosfunksionimi i sistemeve të pompimit të ujërave të deponisë, kompresimi jo i mirë i mbeturinave të deponuara si dhe mbulimi jo adekuat i mbeturinave. Në kuadër të përbërjes së mbeturinave, mbeturinat organike marrin pjesë me 30.4%, plastika 20%, letër dhe karton 15%, mbeturinat e gjelbra me 5%, tekstili 5%, qelqi 5%. Gjatë vitit 2023 ka pasur një rënie prej 2% të mbeturinave spitalore të trajtuara-sterilizuara. Përkundër angazhimit të vazhdueshëm të institucioneve qendrore, komunave dhe donatorëve, deponitë ilegale vazhdojnë të jenë sfidë e këtij sektori. Gjatë vitit 2023 janë regjistruar rreth 400 deponi ilegale të mbeturinave që krahasuar me vitin 2022 shenon një rënie prej 50%. Aktivitetet për ndarjen në burim, trajtimin e mbeturinave, riciklimin e mbeturinave dhe aspektet tjera që ndërlidhen me ekonominë qarkore ende janë në një shkallë të ulët.

Zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti - Gjatë vitit 2023 regjistri kombëtar i zonave të mbrojtura është shtuar edhe për 3 zona të reja, ndërsa kanë filluar procedurat për vënie në mbrojtje edhe të 30 zonave të reja. Numri i zonave të mbrojtura në vitin 2023 ishte 260, me një sipërfaqe prej 126,115.8 ha ose 11.6% e territorit të Kosovës. Përkundër rritjes së vazhdueshme të numrit të zonave të mbrojtura dhe sipërfaqes së tyre, menaxhimi efikas i zonave të mbrojtura dhe parandalimi i veprimeve ilegale në këto zona vazhdon të mbetet problem për institucionet e Kosovës. Ka ende zona të mbrojtura që gëzojnë status të veçantë të mbrojtjes të cilat ende nuk kanë organe menaxhuese përkatëse. Problem, vlerësohet të jetë edhe mungesa e planeve

menaxhuese dhe planeve rregulluese për zonat e mbrojtura. Ka mungesë të programeve të veçanta për monitorimin e biodiversitetit në përgjithësi apo llojeve të veçanta. Vlerësohen disa iniciativa dhe projekte ndërkufitare si aktivitete me rëndësi dhe me ndikim pozitiv për menaxhimin ndërkufitar të zonave natyrore.

Shëndeti publik- Numri i sëmundjeve ambientale (te cilat ndikohen nga gjendja e mjedisit) të regjistruara gjatë vitit 2023 ka shënuar rënie.

Mjediset e rrezikuara- në mënyrë më specifike në raport është trajtuar gjendja mjedisore në zonat e veprimit të operatorëve të KEK, Feronikel dhe Sharrcem, ku janë trajtuar aspektet e përgjithshme të menaxhimit të mjedisit, duke përfshirë emetimet në ajër, shkarkimet në ujë, menaxhimi i mbeturinave industriale si dhe aspekte tjera mjedisore. Në raport janë prezantuar edhe të dhëna të përgjithshme edhe për 17 lokacione të tjera të cilat konsiderohen si hotspote mjedisore e që janë krijuar kryesisht si rezultat i veprimtarisë industriale të së kaluarës, të shkaktuara nga aktivitetet e minierave nga deponitë e vjetra të pa menaxhuara, nga kimikate të deponuara, vajra mbeturinë, pesticide, herbicide etj.

Masat e ndërmarra për përmirësimin e gjendjes së mjedisit - Kosova vazhdon angazhimin e saj në harmonizimin e legjislacionit nacional me direktivat e BE-së, megjithëse sfidë mbetet implementimi i tyre. Janë hartuar dhe aprovuar strategji dhe plane veprimi për të gjithë sektorët mjedisor si në nivelin qendror dhe atë lokal, mirëpo niveli i zbatimit të tyre është i pjesshëm. Edhe pse gjatë vitit 2023 janë realizuar aktivitetet inspektuese dhe mbikëqyrëse në sektorin e mbrojtjes së natyrës, aktivitetet ilegale që degradojnë dhe dëmtojnë mjedisit janë ende në numër shqetësues. Përkundër mungesës së stafit dhe mungesës së zbatimit të rregulloreve për strukturën organizative institucionale, institucionet mjedisore po përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në mënyrë të kënaqshme dhe ka raste kur arrihen edhe rezultate mbresëlënëse. Ndonëse është rritur buxheti për projekte kapitale mjedisore, dhe gjithashtu është rritur edhe numri i projekteve nga donatorët, nevoja dhe kërkesa për investime në mjedis mbetet ende e lartë.

3. Gjendja e mjedisit dhe trendi

3.1. Ajri

3.1.1. Cilësia e ajrit


Monitorimi i cilësisë së ajrit është një proces i rëndësishëm që përfshin mbledhjen dhe analizën e të dhënave mbi ndotësit e ajrit në një zonë të caktuar. Ky proces ndihmon në identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të saj në shëndetin e popullsisë dhe mjedisin, si dhe në zhvillimin e politikave dhe masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Monitorimi është kryer në pika strategjike të zgjedhura për të përfaqësuar nivelet e ndotjes në zona të ndryshme në: zona urbane, suburbane industriale dhe rurale. Këto pika janë të pajisura me stacione monitoruese që regjistrojnë nivelet e ndotësve të ajrit. Monitorimi posedon një infrastrukturë specializuar që konsiston në një rrjet të integruar me 12 stacione statike dhe 1 stacioni mobil. Parametrat e monitoruar janë: PM10, PM 2.5, O3, SO2, NO2 dhe CO. Në shtojcën 1 te raportit janë prezantuar lokacionet e stacioneve te monirorimit të cilësisë së ajrit dhe karakteristikat e tyre.

Standardet e cilësisë së ajrit në Kosovë bazohen në direktivat e BE-së për cilësinë e ajrit, (2008/50/EC Direktiva për Ajër më të Pastër direktivë e cila përcakton pragjet e përqendrimeve të ndotësve që nuk duhet të tejkalohen për një periudhë të caktuar kohore. Legjislacioni për mjedis i Kosovës është harmonizuar me standardet e cilësisë së ajrit për nivelet afatshkurta (me orë apo ditë) dhe afatgjata (me vjet) të cilësisë së ajrit. Standardet për nivelet afatgjata janë më strikte se nivelet afatshkurta, pasi që mund të kenë efekte serioze shëndetësore nga ekspozimi afatgjatë ndaj ndotësve. Në shtojcën 2 janë prezantuar Normat e Cilësisë së Ajrit sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011.

Indeksi i Cilësisë së Ajrit (ICA) tregon situatën afatshkurtër të cilësisë së ajrit. Nuk pasqyron situatën afatgjate (vjetore) të cilësisë së ajrit, që mund të dallon në mënyrë të konsiderueshme. Duhet të theksohet që ICA nuk është mjet për kontrollimin e përmbushjes së standardeve të cilësisë së ajrit dhe nuk mund të përdoret për këtë qëllim. Në shtojcën 3 është prezantuar niveli i Indexit të Cilësisë së Ajrit bazuar në përqendrimin e ndotësve, shprehur në $\mu g/m^3$.

Kushtet meteorologjike janë një faktor shumë i rëndësishëm që kontribuojnë në cilësinë e ajrit të një zone. Në hartën vijuese janë prezantuar drejtimet e erës në Kosovë.



Harta 1: Drejtimet e lëvizjes së erës

Zonat e monitoruara- Monitorimi i cilësisë së ajrit është i ndarë në dy zona, në atë Aglomerate (AKS1) të cilët janë të vendosur 2 në kryeqytet (IHMK, Rilindje) dhe 3 Obiliq (Qendra Obiliq, Dardhishtë dhe Palaj), dhe Zonën ZKS1 në Gjilan, Hani Elezit, Brezovicë, Prizren, Pejë, Drenas dhe Mitrovicë, ndërsa stacioni mobil përdoret varësisht prej kërkesave nga inspektorati dhe kërkesave tjera.

Vlerësimi i të dhënave - Në tabelën 1 dhe në figurën 1 janë paraqitur të dhënat për cilësinë e ajrit për vitin 2023 në mesatare vjetore dhe numri i ditëve me tejkalime. Të dhënat tregojnë se për parametrin PM10, mesatarja vjetore nuk ka tejkaluar vlerën kufitare prej 40 µg/m³ në asnjë nga stacionet monitoruese. Po ashtu, për parametrat e tjerë të monitoruar, nuk ka pasur tejkalime të vlerave kufitare të mesatares vjetore në të gjithë zonën e Aglomeracionit. Megjithatë, numri i ditëve me tejkalime për parametrin PM10, sipas standardit prej 35 ditë në vit, tregon se vetëm një stacion monitorimi në zonën aglomerate-AKS1, konkretisht Prishtinë-Rilindje, ka regjistruar tejkalime.




Figura 1: *Parametrat e monitoruar në AKS 1*

Tabela 1: Të dhënat për cilësinë e ajrit sipas parametrave dhe stacioneve monitoruese në zonën aglomerate për vitin 2023

Stacionet	PM 10 µg/m^3	PM 2.5 µg/m^3	O3 µg/m^3	SO2 µg/m^3	NO2 µg/m^3	CO mg/m^3	Nr. Ditëve me tejkalime për PM10
Drenas	16.17	12.25	54.83	6.42	11.83	0.66	8
Mitrovicë	23.83	16.50	26.58	22.42	9.42	0.48	25
Pejë	21.25	15.75	52.33	6.08	14.92	0.83	24
Prizren	17.75	12.92	54.42	8.92	16.08	0.68	15
Brezovicë	9.25	7.00	82.33	4.67	1.42	0.46	1
Hani Elezit	17.58	13.17	48.58	6.25	14.83	0.53	4
Gjilan	24.42	21.25	51.58	6.92	20.08	0.43	43

Në këtë tabelën 2 dhe figurën 2 janë të paraqitur të dhënat e cilësisë së ajrit në mesatare vjetore si dhe numri i ditëve me tejkalime për shtatë stacionet monitoruese të ZKS1. Sipas këtyre të dhënave, nuk ka pasur tejkalime të standardeve për mesataret vjetore të parametrave të monitoruar. Megjithatë, për parametrin PM10, sipas standardit prej 35 ditë brenda vitit, është regjistruar tejkalim vetëm në stacionin e Gjilanit me 43 ditë.

Tabela 2: Të dhënat për cilësinë e ajrit sipas parametrave dhe stacioneve monitoruese ZKS1 për vitin 2023

Stacionet	PM 10 µg/m^3	PM 2.5 µg/m^3	O3 µg/m^3	SO2 µg/m^3	NO2 µg/m^3	CO mg/m^3	Nr. i ditëve me tejkalime për PM10
Prishtinë/IHMK	19.83	14.08	13.00	10.48	23.50	0.89	20
Prishtinë/Rilindje	28.58	19.33	7.33	9.88	14.33	0.43	36
Palaj	14.75	10.25	5.92	11.3	8.83	0.09	6
Obiliq	18.92	15.25	9.25	9.38	15.92	0.84	20
Dardhishtë	15.33	11.58	5.25	8.82	11.08	0.97	14




Figura 2: *Parametrat e monitoruar në ZKS 1*

Trendi i cilësisë së ajrit - Në bazë të të dhënave të monitoruara nga viti 2013-2023 është bërë edhe analiza e trendit të cilësisë së ajrit për mes të cilave konstatojmë se kemi një përmirësim të cilësisë së ajrit në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Analiza e trendit është bërë në bazë koncentrimit vjetor. Viti 2023 ka një ulje të ndjeshme të vlerave krahasuar me vitin 2022 sidomos për parametrat PM10 dhe PM2.5. Në figurat e më poshtme është paraqite trendi i cilësisë së ajrit për parametrat PM_{10}, $PM_{2.5}$, O_3, SO_2, NO_2 dhe CO nga viti 2013-2023.




Figura 3: *Trendi i mesatareve vjetore të PM_{10} për vitet 2013-2023*




Figura 4: *Trendi i mesatareve vjetore të $PM_{2.5}$ për vitet 2013-2023*




Figura 5: *Trendi i mesatareve vjetore të O_3 për vitet 2013-2023*




Figura 6: *Trendi i mesatareve vjetore të SO_2 për vitet 2013-2023*




Figura 7: *Trendi i mesatareve vjetore të CO për vitet 2013-2023*




Figura 8: *Trendi i mesatareve vjetore të NO_2 për vitet 2013-2023*

3.1.2. Emisionet në ajër

Inventari i emisioneve ofron një vlerësim të sasisë së ndotësve që lirohen në ajër nga burime të ndryshme. Inventari është një nga mjetet kryesore të përdorura në menaxhimin e cilësisë së ajrit, me që ofron informata përmes të cilave kuptojmë se cilët janë kontribuuesit e ndotjes së ajrit sipas aktiviteteve dhe burimeve, duke mundësuar kështu ndërmarrjen e veprimeve efektive për të zvogëluar emetimet si dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit në mjedis.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, në baza vjetore bën vlerësimin e emisioneve në ajër, bazuar në konsumin e lëndëve djegëse. Gjatë vitit 2024 është bërë vlerësimi për emetimet në ajër, bazuar në konsumin e lëndëve djegëse për vitin 2022. Në tabelën 3 janë prezantuar të dhënat për ndotësit kryesore sipas burimeve ndotëse.

Tabela 3: Emisionet në ajër nga ndotësit kryesor sipas burimeve të emetimeve (ton/vit)[2]

Burimet e emetimeve	NO_2	SO2	PM2.5	PM10	PT[3]	NMVOC	CO
Industria energjetike (prodhimi i energjisë dhe ngrohjes)	15,590	105,990	210	500	740	90	550
Industria prodhuese dhe e ndërtimit	4,290	1,120	330	340	350	440	1,630
Transporti (aviacioni, automjetet dhe hekurudhat)	9,310	850	360	360	360	450	1,200
Djegiet e vogla (komerciale, rezidenciale dhe nga bujqësia)	1,530	610	7,390	7,600	7,990	6,140	40,230
Gjithsej (ton/vit)	**30,720**	**108,570**	**8,290**	**8,800**	**9,440**	**7,120**	**43,610**

Sikurse shihet edhe nga të dhënat e prezantuara në tabelë, burimi kryesor i emetimeve për ndotësit NO_2 dhe SO_2 është prodhimi i energjisë dhe ngrohja, ndërsa sa i përket ndotësve PM2.5, PM10, Pluhurit total dhe Monoksidit të karbonit (CO) burimi kryesor i tyre është ai i djegieve të vogla, ku përfshihen burimet residenciale, institucionale dhe komerciale. Transporti është burimi i dytë i ndotjes për NO2 pas sektorit të prodhimit të energjisë, ndërsa industria prodhuese është sektori i dytë për ndotje me CO pas djegieve të vogla.

Krahasuar me emetimet e vitit 2021, gjatë vitit 2022 është shënuar një rënie e emetimeve për të gjithë ndotësit krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa gjatë periudhës 2014-2022, viti 2016 është viti me emetimet më të larta (figura 9).

[2] *Raporti vjetor i AMMK per emisionet në ajër sipas kërkesave të CLRTAP raportuar në Agjencinë e Mjedisit të Europës (https://cdr.eionet.europa.eu/xk/un/clrtap/inventories/envyfo8xa/)*
[3] *Pluhuri Total*




Figura 9: *Trendi i emetimeve në ajër 2014-2022 (ton/vit)*

Për të reduktuar ndotjen dhe për të zvogëluar emetimet nga burimet e ndryshme, kërkohet që të hartohen politika favorizuese për shfrytëzimin e lëndëve djegëse që kanë shkarkime më të ulëta në mjedis, si dhe për zbatimin e teknologjive të pastra në proceset e prodhimit. Po ashtu rekomandohet të favorizohet shfrytëzimi i transportit alternativ, që ka shkarkime më të ulëta në ajër dhe të aplikohet kufizimi kohor i përdorimit të automjeteve të vjetra dhe atyre pa katalizatorë.

Ndër masat tjera që duhet te zbatohen janë: rritja e efiçiencës së energjisë së ndërtesave dhe shtimi i hapësirave të gjelbra dhe promovimi, si dhe zbatimi teknologjive të pastra në proceset industriale në funksion të zvogëlimit të emetimeve në ajër, etj.

3.1.3. Emisionet e gazrave serrë (GHG)

Në kuadër të aktiviteteve për vitin 2024, AMMK ka bërë edhe vlerësimin e emetimeve të gazrave serrë për vitin 2022 bazuar në bilancin e energjisë.
Sektori i energjisë është burimi kryesor i emetimeve të gazrave serrë me pjesëmarrje prej rreth 86% të totalit te emetimeve. Ne kuadër te sektorit te energjisë, burimet kryesore te emetimeve janë: industria energjetike, transporti, industria e prodhimit dhe ndërtimit dhe konsumi i energjisë për ngrohje në ndërtesa rezidencial, komerciale dhe institucionale. Në vitin 2022 janë emetuar 8879 Gg CO2 eq. , krahasuar me vitin paraprak emetimet kanë rënë për 344 Gg CO2 eq (tabela 4).

Tabela 4: Emetimet e gazrave serrë (Gg) nga sektori i Energjisë për vitin 2022

Kategoria (sektori) i konsumit te burimeve energjetike	**CO2**	**CH4**	**N2O**	**Totali CO2 eq.**
Industria energjetike (prodhimi i energjisë dhe ngrohjes)	6381	0.06	0.09	**6409.32**
Industritë e prodhimit dhe ndërtimit (prodhimi i metaleve, jo metaleve, kimikateve, ushqimit etj.)	749	0.05	0.01	**753.23**
Transporti (transporti rrugor)	1320	0.05	0.01	**1324.23**
Sektorët tjerë që konsumojnë energji (konsumi në amvisëri, ndërtesa institucionale dhe komerciale, bujqësia etj.)	302	3.03	0.05	**392.65**
Totali i emetimeve	**8752**	**3.19**	**0.16**	
Totali i emetimeve CO2. Eq.	**8752**	**79.75**	**48**	**8879**

Gazi kryesor i emetuar nga sektori i energjisë është CO_2 me 99%, ndërsa Metani (CH_4) N_2O përfaqësojnë vetëm 1% të emetimeve.

Për uljen e emetimeve të GHG nga sektori i energjisë rekomandohet rritja e kapaciteteve për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtritshme të energjisë, rritjen e numrit të veturave me karburante alternative dhe elektrike, ndërrimin e lëndëve djegëse për ngrohje, zgjerimin e sistemeve për ngrohje qendrore si dhe rritja e efiçencës së energjisë në ndërtesa.

3.2. Uji

Burimet e përgjithshme të ujit në Kosovë përdoren kryesisht për qëllime urbane, industriale dhe bujqësore, andaj edhe zhvillimi industrial, urbanizimi, bujqësia intensive janë vetëm disa prej faktorëve që ndikojnë në ndotjen e ujërave. Përkundër angazhimit të vazhdueshëm, shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve, ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve tona ujore.

Problemi më kritik aktual është ndotja e ujërave siperfaqësor që shkaktohet nga shkarkimi i ujërave, presionet e tilla vijnë kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të ujërave të shkarkuara pa trajtimin adekuat fizik, kimik e biologjik. E gjithë kjo ndikon në rritjen e vlerave të parametrave fizikë, kimik dhe mikrobiologjik në trupat ujore. Presione të tjera nga reshjet janë shpëlarja e tokave bujqësore dhe sipërfaqeve të tjera ndotëse me ç'rast vije deri te rritja e materieve të suspenduara, materive inorganike (fertilizerët-N, P, K, NH_4^+ etj.) dhe atyre organike (PCB, Herbicide etj). Ndër presionet më të mëdha në trupat ujore janë shkarkimet industriale të veprimtarive të ndryshme.

Gjatë viteve të fundit janë hartuar politika për një menaxhim më të mirë të burimeve ujore nëpërmjet vendosjes së një kuadri monitorimi dhe kontrolli, për të reduktuar ndotjen e ujërave nëntokësor dhe sipërfaqësor nga aktivitetet e veprimtarive industriale, bujqësore dhe aktiviteteve të popullsise në zonat rurale dhe urbane, që shkaktojnë dëmtim të ekosistemeve ujore, si dhe të lumenjve nga shfrytëzimi pa kriter, menaxhimi i ujërave ndërkufitare, zvogelimi i efekteve nga përmbytja dhe thatësira.

3.2.1. Cilësia e ujërave sipërfaqësore

Monitorimin e ujërave të lumenjve në territorin e Republikës së Kosovës e bën Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Cilësia e këtyre lumenjve përcaktohet në bazë të analizave fizike, kimike dhe metaleve të rënda. Rrjeti i monitorimit ka gjithsej 54 vend mostrime (stacion monitoruese). Parametrat fizik që aktualisht monitorohen janë 10 parametra fizik (maten 11 herë në vit), 39 parametra kimik (maten 11 herë në vit) dhe 8 metale të rënda (2 herë në vit).

Në shtojcën 4 të raportit, janë prezantuar parametrat që monitorohen dhe frekuenca e matjeve, kurse në shtojcën 5 është prezantuar tabela me kodet e stacioneve të monitorimit të kualitetit fiziko-kimik të ujërave sipërfaqësore – lumenjtë.

Në këtë raport, gjendja e ujërave është pasqyruar përmes treguesve (parametrave): Oksigjeni i tretur (mg/l O_2); Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit- $SHBO_5$ (mg/l O_2), Shpenzimi kimik i oksigjenit- SHKO (mg/l O_2); Karboni organik total-C (mg/l);

Fosfori total – P (mg/l), Materiet Totale të Suspenduara-MTS (mg/L). Vlerat e prezentuara në grafikon janë si vlera mesatare për vitin 2023.

Parametrat si: Oksigjeni i tretur (O2), Oksigjeni Biokimik i Shpenzuar për 5 ditë ($SHBO_5$), Shpenzimi Kimik i Oksigjenit (SHKO), tregojnë nivelin e ndotjes organike dhe bakteriologjike të ujit i cili hynë në grupin e parametrave të cilët pritet të kanë presione nga ato dukuri që u cekën më lartë. Derisa, prezenca e Fosforit (P_{tot}) shkakton eutrofikimin në ujëra.

Pellgu i Drinit të Bardhë – Në këtë pellg përzgjedhja e pikave monitoruese është bërë për dy lumenjtë: lumi Drini i Bardhë dhe lumi Ereniku, ku si vlera mesatare vjetore të ngritura paraqiten materiet totale të suspenduara /mg/l (MTS) dhe atë në stacionet monitoruese përgjatë rrjedhjes së lumenjëve duke përjashtuar stacionet referente (vendburimet).




Figura 10: *Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjë- IHMK 2023 (Pellgu i Drinit të Bardhë)*

Pellgu i Ibrit – Në këtë pellg përzgjedhja e pikave monitoruese është bërë për këta lumenjë: Ibri, Sitnica, Prishtevka, Graqanka dhe Drenica (figura 2), nga ku vërehet se lumi Prishtevka/Bresje dhe Graqanka/Vragoli pothuajse me të gjithë parametrat e paraqitur tregon vlera më të ngritura, ngase vetë shtrirja e lumit është përgjatë zonës më të populluar dhe që përfshinë edhe zona industriale.




Figura 11: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjë- IHMK 2023 (Pellgu i Ibrit)

Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit - Në pellgun Morava e Binçës është përzgjedhur lumi Morava e Binçës me gjithsej katër stacione monitoruese (figura 3), ku ngritje e theksuar është parametri shpenzimi kimik i oksigjenit. Ndërsa në Pellgun e Lepencit, janë përzgjedhur dy lumenj: ai i Lepencit dhe Nerodimja, ku edhe këtu shpenzimi kimik i oksigjenit tregon ngritje përgjatë rrjedhjes së lumit.




Figura 12: *Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjë- IHMK 2023 (Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit)*

Bazuar në këto tri grafikone (shtrirjen territoriale në të gjitha pellgjet) ku prezenca e sasisë së fosfori total/ mg/l P nga analizat e bëra tregojnë se sasia e fosforit në ujërat e lumenjve nuk paraqet ndikim të shprehur në ujërat sipërfaqësore, sepse vlerat e tij të paraqitura në diagramet për vitin 2023 gjendet në mes 0.10 mg/l P

(Ibër/Kushtovë) dhe 4.54 mg/l P (Prishtevka/Bresje). Nga konstatojmë se ujërat sipërfaqësore në Kosovës nuk janë të rrezikuar me eutrofikim.

Po ashtu, edhe treguesi Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit ($SHBO_5$), gjatë periudhës së monitorimit për vitin 2023, tregon se vlerat e përllogaritura gjenden në mes të 0.18 mg O_2/l Ereniku / Jasiq dhe 74.32 mg O_2/l, në lumin Graqanka/Vragoli. Ku për këtë vit, lumenjt Prishtevka/Bresje dhe Graqanka/Vragoli tregon për ndotje me vlerën më të lartë mesatare vjetore. Edhe pse në kushte natyrore ujërat e pastra nuk posedojnë fare sasi të $SHBO_5$, kjo ndotje arsyetohet me faktin që ujërat sipërfaqësor i ekspozohen gjithnjë shkarkimeve të ujërave të ndotura përmes të cilave dhe krijohen kushte optimale për rritjen e vlerës së $SHBO_5$.

Programi i Qeverisë për investime në menaxhimin e ujërave të ndotura, në kuadër të investimeve të planifikuara 2017-2021, së bashku me donatorët kanë kryer investime në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në vlerë mbi 60 milion EUR (ITUN për Prizrenin, Pejën dhe Gjakovën).

Investimet e tilla në ITUN në Pellgun e Drinit të Bardhë, edhe pse në fazat fillestare, ka rezultuar me përmirësim të cilësisë së ujërave në lumenj. Në figurën 4 është paraqitur trendi për tri vitet 2021,2022 dhe 2023.





Figura 13: *Trendi nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjë në Pellgun e Drinit të Bardhë për vitet: 2021, 2022 dhe 2023*

Trendi i ndryshimit të gjendjes së ujërave për vitet 2022 dhe 2023, për stacionet përkatëse monitoruse për treguesit e përfshirë në këtë vlerësim është prezantuar në tabelën 5.

Tabela 5: Trendi i cilësisë së ujërave të lumenjve 2022-2023

Stacionet monitoruese	Oksigjeni i tretur/ mg/l O_2	Shpenzimi biokimik i oksigjenit/ mg/l O_2 ($SHBO_5$	Shpenzimi kimik i oksigjenit/ mg/l O_2 (SHKO)	Karboni organik total/ mg/l C	Fosfori total/ mg/l P	Materiet totale të suspenduara/ mg/L (MTS)
RV01_011	↓	↑	↑	↓	↓	↑
RV01_012	↓	↑	↑	↓	↔	↑
RV01_013	↓	↓	↓	↓	↓	↓
RV01_071	↓	↓	↓	↓	↓	↑
RV01_072	↓	↑	↓	↑	↑	↑
RV02_011	↑	↑	↑	↑	↑	↑
RV02_012	↓	↑	↓	↑	↓	↑
RV02_013	↓	↓	↓	↓	↔	↑
RV02_023	↔	↔	↔	↔	↑	↔
RV02_024	↑	↑	↓	↓	↑	↑
RV02_026	↓	↑	↑	↑	↑	↑
RV02_041	↑	↑	↑	↑	↑	↓
RV02_051	↑	↑	↑	↑	↔	↑
RV02_061	↓	↓	↑	↓	↑	↑
RV02_062	↑	↑	↑	↑	↑	↑
RV03_011	↓	↑	↑	↑	↓	↓
RV03_012	↑	↑	↑	↓	↑	↑
RV03_013	↓	↓	↓	↓	↑	↑
RV03_014	↓	↓	↓	↓	↓	↑
RV04_011	↑	↓	↓	↓	↓	↑
RV04_012	↓	↑	↑	↑	↑	↑
RV04_013	↓	↑	↑	↑	↑	↑
RV04_021	↑	↑	↑	↑	↑	↑
RV04_023	↑	↑	↑	↑	↔	↑
RV04_024	↓	↑	↓	↑	↑	↑



Harta 2: Rrjeti i ujrave sipërfaqësore në Kosovë

Cilësia e ujërave nëntokësore

Ky raport është i bazuar në rezultatet e programit pilot të monitorimit për tri pellgjet lumore: Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci. Programi është mbështetje e projektit MIRU-K dhe realizuar nga IHMK.

Objektivi i programit pilot të monitorimit për tri pellgjet lumore është të vendosë dhe testoj një qasje fillestare për monitorim e ujërave nëntokësor në këto tri pellgje, ashtu që në të ardhmen ky program të mund të shërben si udhërrëfyes i rrjetit kombëtar të monitorimit të ujërave nëntokësore.

Realizimi i këtij pilot projekti është bërë në kuadër të fazës së parë të projektit me një frekuence matje dy herë në vit (përkatësisht sezonin e pranverës dhe vjeshtës), me gjithsejtë 20 pika monitoruese për tri pellgjet: Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci.

Më poshtë po i paraqesim grafikonet për tre parametrat më signifikant për vlerësimin e cilësisë së ujërave nëntokësore.




Figura 14: Parametri nitrat nga monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësor- IHMK/MIRU 2023 (Pellgjet: Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci)

Për qëllime të vlerësimit të statusit kimik të ujërave nëntokësore janë përdorur standardet e cilësisë së ujërave nëntokësore sipas Direktivës për ujërat nëntokësore [4]dhe Direktivës për ujin e pijshëm [5].

Në figurën 15 është paraqitur parametri nitrat (mg/l) në tri pellgjet: Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci. Sipas këtyre standardeve, pikat monitoruese që e tejkalojnë vlerën standarde për parametrin nitrat janë: Ibër UN02_150 dhe UN02_170 si dhe Morava e Binçës UN03_100.

[4] DIRECTIVE 2006/118/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 12 December 2006 on the protection of groundwater against pollution and deterioration
[5] DIRECTIVE (EU) 2020/2184 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 16 December 2020 on the quality of water intended for human consumption




Figura 15: Parametri nitrit nga monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësore- IHMK/MIRU 2023 (Pellgjet: Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci)

Në figurën 16 është paraqitur parametri nitrit (mg/l) në tre pellgjet: Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci. Sipas këtyre standardeve në të gjitha pikat monitoruese nuk ka tejkalim të vlerës standarde për parametrin nitrit.





Figura 16: *Parametri amonium nga monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësor- IHMK/MIRU 2023 (Pellgjet: Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci)*

Sipas këtyre standardeve vetëm në pellgun e Ibrit, pika monitoruese UN02_130 ka tejkalim të vlerës standarde për parametrin amonium.

Në shtojcën 6 të këtij raporti gjeni tabelën me kodet e stacioneve të monitorimit të kualitetit fiziko-kimik të ujërave nëntokësore, ndërsa në hartën 3 është prezantuar shpërndarja e lokacioneve të stacioneve të monimotimit të cilësisë fiziko-kimike të ujërave nëntokësore.



Lokacioni	KODI Kombetar i propozuar	Lokacioni	KODI Kombetar i propozuar
Jalovic/Klinë	UN01_100	Osllq	UN02_102
Kosaglaitag	UN01_101	Vragoi	UN02_103
Kosaglaitag	UN01_102	Dopomar/Mlavsh	UN02_104
Kosaglaitag	UN01_103	Lazhor	UN02_105
Bugar/Fierë	UN01_104	Kozhnik	UN02_106
Burgj/Shkndarai	UN01_105	Sertovec	UN02_107
Prepojan/Llecan	UN01_106	Pasjan	UN03_100
Mogilce/Shkugë	UN01_107	Pasjan	UN03_101
Mogilcë/Gjakovë	UN01_108	Pasjan	UN03_102
Prizren/B.Curr	UN01_109	Pasjan	UN03_103
Gomnec/Suhareka	UN01_110	Lapovë	UN03_104
Dejn/Rahovec	UN01_111	Lapovë	UN03_105
Zegaxhi/Rahovec	UN01_112	Nemotime	UN04_100
Cyshk/Pejë	UN01_113	Nemotime	UN04_101
Tërstenik	UN01_114	Ferizaj/Talinoc	UN04_102
Vitomirica	UN01_115	Ferizaj/Kamenic	UN04_103
Çikatovë	UN01_116	Lumi i Vogël	UN04_104
Kotlush/Ujëvar	UN02_100	Lum i Madh	UN04_105
Osllq	UN02_101		

Harta 3: *Shpërndarja e lokacioneve të stacioneve të monimotimit të cilësisë fiziko-kimike të ujërave nëntokësore*

Monitorimi bologjik i ujërave sipërfaqësore

Monitorimi biologjik në pellgun e lumit Ibër, pellgun e lumit Morava e Bincës dhe pellgun e lumit Lepenc[6]

Programi Pilot i Monitorimit për pellgjet lumore në Kosovë është një hap i rëndësishëm për përmirësimin e menaxhimit të resurseve ujore dhe përputhjen me standardet e BE-së. Implementuar nga Programi i Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore dhe Qeveria e Kosovës, ky program ka testuar një qasje për monitorimin e cilësisë së ujit në pellgjet e Ibrit, Lepencit, dhe Moravës së Binçës.

Monitorimi Biologjik - Direktiva Kornizë e Ujit e BE-së kërkon vlerësimin e cilësisë së ujit përmes indikatorëve të ndryshëm, përfshirë makroinvertebrorët, peshqit dhe diatomet, të cilët ofrojnë një pasqyrë më të saktë të ndikimeve antropogjene në ekosisteme, duke integruar ndryshimet biogjeokimike brenda sistemit biologjik.
Monitorimi, i realizuar tre herë në vit (pranverë, verë, vjeshtë) për elementët biologjikë, do të ndihmojë në përmirësimin dhe zgjerimin e qasjes në gjithë Kosovën, duke pasur parasysh kërkesat e Direktivës Kornizë të Ujit të BE-së. Aktiviteti i monitorimit është zhvilluar gjatë një periudhe 12 mujore, nga prilli 2023 deri në shkurt 2024 për të mbledhur të dhëna të plota dhe për të vlerësuar ndryshimet sezonale në cilësinë e ujit.

Rezultatet përmbledhëse të monitorimit biologjik në pellgun e Ibrit

Përbërja e diatomeve - Në 33,4 % të trupave ujore diatomet janë në gjendje/potencial të lartë dhe të mirë. Totali i specieve të identifikuara: 196 lloje diatome që janë identifikuar në të gjitha lokacionet e kampionimit, sezoni i pranverës rreth 139 lloje, sezoni i verës rreth 187 lloje, sezoni i vjeshtës përfaqëson numrin më të madh të specieve.

Tabela 6: Statusi ekologjik i trupave ujorë në pellgun e lumit Ibër-diatomet

Nr.	Id / Kodi	Lokaliteti	Pranverë	Verë	Vjeshtë	2023
			Statusi ekologjik	Statusi ekologjik	Statusi ekologjik	Kompozicioni
1	1 RV02_011	Ibri - Kushtovë	mirë	lartë	lartë	lartë
2	2 RV02_012	Ibri - Mitrovicë	i moderuar	mirë	i moderuar	i moderuar
3	3 RV02_013	Ibri -Kelmend	i varfër	i varfër	keq	i varfër
4	4 RV02_021	Sitnica - Bablak	i varfër	i varfër	keq	i varfër
5	5 RV02_024	Sitnica - Plemetin	i varfër	i varfër	i varfër	i varfër
6	6 RV02_025	Sitnica - Nedakovc	i moderuar	i varfër	i varfër	i varfër
7	7 RV02_026	Sitnica - Mitrovicë	i varfër	i varfër	i varfër	i varfër
8	8 RV02_031	Llapi - Murgullë	mirë	mirë	mirë	mirë
9	9 RV02_033	Llapi - Milloshevë	i moderuar	i varfër	i moderuar	i moderuar

[6] *Programi Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë (Final Report Pilot Monitoring of Surface Water and goundwater In Ibri River Basin, Morava e Binces River Basin and Lepenc River Basin), April 2023 – February 2024.*

10	10 RV02_041	Prishtevka - Bresje	keq	keq	i varfër	keq
11	11 RV02_051	Graqanka - Vragoli	keq	keq	keq	keq
12	12 NCA	Drenica - Krojmir	mirë	i moderuar	i moderuar	i moderuar
13	13 RV02_061	Drenica -Pjetershtice	mirë	mirë	mirë	mirë
14	14 RV02_062	Drenica - Vragoli	i moderuar	i moderuar	i varfër	i moderuar
15	15 RV02_071	Shtimljanka - Devetak	i moderuar	mirë	mirë	mirë
16	16 RV02_072	Shtimljanka - Muzeqin	i varfër	i varfër	i varfër	i varfër
17	17 XK-02-08-03	Reservoir - Batlava	i moderuar	mirë	mirë	mirë
18	18 XK-02-16-01	Reservoir - Gazivode	mirë	lartë	mirë	mirë

Makroinvertebrorët - Në 16,7 % të trupave ujore makroinvertebrorët janë në gjendje/potencial të lartë dhe të mirë. Statusi i përmbledhur ekologjik i përbërë bazuar në makroinvertebrorët dhe bazuar në monitorimin e të tre sezonave tregon se në tre zona monitorimi makroinvertebrorët janë me status të mirë [16,7 %], tre janë me status të moderuar [16,7 %] , 8 me status të dobët [44,4 %] dhe pjesa tjetër e 4 vendeve monitoruese me status të keq [22,2 %]. Të gjitha lokacionet me status të mirë ndodhen në zonat e rrjedhës së sipërme të lumit Ibër, lumit Llap dhe lumit Shtime. Vendet e monitorimit me status të keq ndodhen në lumin Sitnica dhe dy degët e tij, Prishtinë dhe Graçankë. Presionet antropogjene në zona të tjera reflektohen në statusin e këtyre zonave të monitorimit përmes statusit të varfër ose të moderuar.

Tabela 7: Statusi ekologjik i trupave ujorë në pellgun e lumit Ibër- makroinvertebrorët


Nr.	Id / Kodi	Lokalitetit	Pranverë	Verë	Vjeshtë	2023
			Statusi Ekologjik	Statusi ekologjik	Statusi Ekologjik	Kompozicioni
1	RV02_011	Ibri - Kushtovë	i moderuar	mirë	mirë	mirë
2	RV02_012	Ibri Mitrovicë	i varfër	i varfër	keq	i varfër
3	RV02_013	Ibri -Kelmend	i varfër	i varfër	keq	i varfër
4	RV02_021	Sitnica - Bablak	i varfër	i varfër	keq	i varfër
5	RV02_024	Sitnica - Plemetin	keq	keq	keq	keq
6	RV02_025	Sitnica - Nedakovc	i varfër	keq	keq	keq
7	RV02_026	Sitnica - Mitrovicë	i varfër	i varfër	keq	i varfër
8	RV02_031	Llapi - Murgullë	mirë	lartë	mirë	mirë
9	RV02_033	Llapi - Milloshevë	i varfër	i varfër	i varfër	i varfër
10	RV02_041	Prishtina - Bresje	keq	keq	keq	keq
11	RV02_051	Graqanka - Vragoli	keq	keq	keq	keq
12	NCA	Drenica - Krojmir	i varfër	i moderuar	i moderuar	i moderuar
13	RV02_061	Drenica -Pjetërshticë	i moderuar	i moderuar	i moderuar	i moderuar
14	RV02_062	Drenica - Vragoli	i varfër	i varfër	i varfër	i varfër
15	RV02_071	Shtime - Devetak	i moderuar	mirë	mirë	mirë
16	RV02_072	Shtime - Muzeqinë	i varfër	i varfër	i varfër	i varfër

17	XK-02-08-03	Batllava	i moderuar	i varfër	i varfër	i varfër
18	XK-02-16-01	Ujmani	i moderuar	i moderuar	i moderuar	i moderuar

Peshqit - janë në gjendje të mirë dhe të lartë në 16,7 % të trupave ujore. Në tre trupa ujore peshqit janë me status të mirë (Ibri-Kushtove, Llapi – Murgulle dhe Shtime – Devetak) [16,7 %], në 4 janë me status të moderuar (Llapi – Milloshevë, Drenicë – Krojmir, Drenicë – Pjetreshtice, rezervuarët Batllavë dhe Gazivode. (Ujmani) [22,2 %], në gjashtë janë me status të dobët [33,3 %], dhe në 5 me status shtrati [27,8 %]. Rezultatet tregojnë se peshqit janë në gjendje të mirë dhe të lartë në 16,7 % të trupave ujore.

Tabela 8: Statusi ekologjik i trupave në pellgut të lumit Ibër-peshqit

Nr.	Id /Kodi	Lokaliteti	Pranverë	Verë	Vjeshtë	2023
			Statusi ekologjik	Statusi Ekologjik	Statusi ekologjik	Kompozicioni
1	RV02_011	Ibri - Kushtovë	mirë	lartë	lartë	lartë
2	RV02_012	IbriMitrovicë	i moderuar	mirë	i moderuar	i moderuar
3	RV02_013	Ibri -Kelmend	i varfër	i varfër	keq	i varfër
4	RV02_021	Sitnica - Bablak	i varfër	i varfër	keq	i varfër
5	RV02_024	Sitnica - Plemetin	i varfër	i varfër	i varfër	i varfër
6	RV02_025	Sitnica - Nedakovc	i moderuar	i varfër	i varfër	i varfër
7	RV02_026	Sitnica - Mitrovicë	poor	i varfër	i varfër	i varfër
8	RV02_031	Llapi - Murgullë	mirë	mirë	mirë	mirë
9	RV02_033	Llapi - Milloshevë	i moderuar	i varfër	i moderuar	i moderuar
10	RV02_041	Prishtevka - Bresje	keq	keq	i varfër	keq
11	RV02_051	Graqanka - Vragoli	keq	keq	keq	keq
12	NCA	Drenica - Krojmir	mirë	i moderuar	i moderuar	i moderuar
13	RV02_061	Drenica -Pjetershtice	mirë	mirë	mirë	mirë
14	RV02_062	Drenica - Vragoli	i moderuar	i moderuar	i varfër	i moderuar
15	RV02_071	Shtimljanka - Devetak	i moderuar	mirë	mirë	mirë
16	RV02_072	Shtimljanka Muzeqinë	i varfër	i varfër	i varfër	i varfër
17	XK-02-08-03	Reservoir Batlava	i moderuar	mirë	mirë	mirë
18	XK-02-16-01	Reservoir Gazivode	mirë	lartë	mirë	mirë



Harta 4: *Lokacionet e monitorimit biologjik në pellgun e lumit Ibë, Morava e Binçes dhe Lepenc*

Rezultatet përmbledhëse të monitorimit - pellgu i lumit Morava e Binçes

Përbërja e diatomeve - Bazuar në vlerat e llogaritura të indekseve të diatomeve, trupat ujore të studiuar kanë statusin ekologjik dhe potencialin e mëposhtëm ekologjik: Një trup ujor ka status të lartë, një ka status të mirë, tre me status të moderuar, një me status të dobët dhe një me status të keq. Vetëm në një trup ujor ose 16,66 % e diatomeve janë në gjendje/potencial të mirë.

Tabela 9: Statusi ekologjik i trupave ujorë në pellgun e lumit Morava e Binçës - diatomet

Nr.	Id / Kodi	Lokaliteti	Pranverë	Verë	Vjeshtë	2023
			Statusi ekologjik	Statusi ekologjik	Statusi ekologjik	Kompozicioni
1	RV03_011	Morava e Binçës - Kurbuliq	lartë	mirë	lartë	lartë
2	RV03_012	Morava e Binçës - Kllokot	mirë	i varfër	i moderuar	i moderuar
3	RV03_013	Morava e Binçës - Uglar	i moderuar	keq	keq	keq
4	RV03_014	Morava e Binçës - Domorovc	i moderuar	i moderuar	i moderuar	i moderuar
5	RV03_021	KrivaReka – Mare	i moderuar	mirë	i moderuar	i moderuar
6	RV03_022	KrivaReka - Domorovc	mirë	i varfër	i varfër	i varfër

Makroinvertebrorët - Në 33,3 % të trupave ujore makroinvertebrorët janë në gjendje/potencial të mirë, asnjë vend monitorimi nuk i përket statusit të lartë, dy zona monitorimi i përkasin statusit të mirë, ndërsa katër të tjerë kanë status të dobët. Duhet theksuar se nivel i lartë i ndotjes është vërejtur veçanërisht në lokacionet e monitorimit në Kllokot dhe Uglar për shkak të shkarkimit të ujërave të zeza nga vendbanimet e afërta si dhe nga bujqësia.

Tabela 10: Statusi ekologjik i trupave ujore në pellgun e lumit Morava e Binçës - makroinvertebrorët

Nr.	Id / Kodi	Lokaliteti	Pranverë	Verë	Vjeshtë	2023
			Statusi ekologjik	Statusi ekologjik	Statusi ekologjik	Kompozicioni
1	RV03_011	Morava e Binçës - Kurbuliq	mirë	mirë	lartë	mirë
2	RV03_012	Morava e Binçës - Kllokot	i varfër	i varfër	i varfër	i varfër
3	RV03_013	Morava e Binçës - Uglar	i varfër	i varfër	i varfër	i varfër
4	RV03_014	Morava - Domorovc	i varfër	i moderuar	i varfër	i varfër
5	RV03_021	Kriva Reka-Marec	mirë	i moderuar	mirë	mirë
6	RV03_022	Morava e Binçës-Kurbuliq	i varfër	i varfër	i moderuar	i varfër

Peshku - Peshqit janë në gjendje të mirë vetëm në një trup ujor ose 16,66 % të trupave ujore.

Tabela 11. Statusi ekologjik i trupave ujore në pellgun e lumit Morava e Binçës - peshqit

Nr.	Kodi	Lokaliteti	Pranverë	Verë	Vjeshtë	2023
			Statusi ekologjik	Statusi ekologjik	Statusi ekologjik	Kompozicioni
1	RV03_011	Kurbuliq	mirë	mirë	mirë	mirë
2	RV03_012	Kllokot	i varfër	i varfër	i varfër	i varfër
3	RV03_013	Uglar	keq	keq	keq	keq
4	RV03_014	Morava Domorovc	i moderuar	i moderuar	i moderuar	i moderuar
5	RV03_021	Marec	i moderuar	i moderuar	i moderuar	i moderuar
6	RV03_022	KrivaRekaDomorovc	i varfër	i varfër	i varfër	i varfër

Rezultatet përmbledhëse të Monitorimit Biologjik - pellgu i lumit Lepenc

Përbërja e diatomeve - Në tre trupa ujore (50 %) diatomet janë në gjendje/potencial të lartë dhe të mirë. Bazuar në vlerat e llogaritura të indekseve të diatomeve, trupat ujore të studiuar kanë statusin ekologjik dhe potencialin e mëposhtëm ekologjik: Një trup ujor ka status të lartë, dy me status të mirë, një me status të moderuar dhe dy me status të dobët.

Tabela 12: Statusi ekologjik i trupave ujorë në pellgun e lumit Lepenc-diatomet

Nr.	Id / Kodi	Lokaliteti	Pranverë	Verë	Vjeshtë	2023
			Statusi ekologjik	Statusi ekologjik	Statusi ekologjik	Kompozicioni
1	RV04_011	Lepenc - PrevallëSubain	lartë	lartë	lartë	lartë
2	RV04_012	Lepenc - Kaçanik	mirë	mirë	mirë	mirë
3	RV04_013	Lepenc - Hani iElezit	mirë	i moderuar	i moderuar	i moderuar
4	RV04_021	Nerodime - Jezerc	mirë	mirë	mirë	mirë
5	RV04_023	Nerodime - Gërlicë	i varfër	i varfër	keq	i varfër
6	RV04_024	Nerodime - Kaçanik	i moderuar	i varfër	i varfër	i varfër

Përbërja e makroinvertebrorëve - Në 66,66 % të trupave ujore makroinvertebrorët janë në gjendje/potencial të mirë. Një lokacion ka status të dobët dhe një me status të keq, që tregon nivel të lartë të ndikimit antropogjen, kryesisht të shkaktuar nga shkarkimi i ujërave të zeza të patrajtuara nga qyteti i Ferizajt. Të dy vendet i përkasin nënpellgut të Nerodimes, i cili është dega kryesore e lumit Lepenci. Katër trupa ujor kanë një status të mirë.

Tabela 13: Statusi ekologjik i trupave ujore në pellgun e lumit Lepenc-makroinvertebrorët

Nr.	Id / Kodi	Lokaliteti	Pranverë	Verë	Vjeshtë	2023
			Statusi ekologjik	Statusi ekologjik	Statusi ekologjik	Kompozicioni
1	RV04_011	Lepenc -Prevallë	mirë	mirë	mirë	mirë
2	RV04_012	Lepenc-Kaçanik	mirë	mirë	i moderuar	mirë
3	RV04_013	Lepenc-Hani iElezit	i moderuar	mirë	mirë	mirë
4	RV04_021	Nerodime-Jezerc	mirë	mirë	mirë	mirë
5	RV04_023	Nerodime-Gërlicë	i varfër	keq	keq	keq
6	RV04_024	Nerodime- Kaçanik	keq	i varfër	i varfër	i varfër

Përbërja e peshkut – Peshqit janë në gjendje të mirë vetëm në një trup ujor ose 16,66 % të trupave ujorë.

Tabela 14: Statusi ekologjik i trupave ujorë në pellgun e lumit Lepenc-peshqit

Nr.	Id / Kodi	Lokaliteti	Pranverë	Verë	Vjeshtë	2023
			Statusi ekologjik	Statusi ekologjik	Statusi ekologjik	Composite
1	RV04_011	Prevallë - Subain	mirë	mirë	mirë	mirë
2	RV04_012	Lepenci - Kaçanik	i moderuar	i moderuar	i moderuar	i moderuar
3	RV04_013	Hani i Elezit	i varfër	i varfër	i varfër	i varfër
4	RV04_021	Jezerc	mirë	mirë	mirë	mirë
5	RV04_023	Gërlicë	keq	keq	keq	keq
6	RV04_024	Nerodimja - Kaçanik	keq	i varfër	keq	keq

3.2.2. Sasia e ujërave sipërfaqësore


Përveç cilësisë së ujërave, IHMK bën edhe monitorimin e sasisë së ujërave. Monitorimi i sasisë së ujërave bëhet përmes rrjetit hidrometrik i cili përbëhet nga një numër i stacioneve matëse nëpër lumenj, ku kryhen matje për sasinë e ujit. Në këto stacione matet Niveli (H) dhe Prurja (Q). Në tabelën 15 janë prezantuar të dhënat për nivelin e ujit H (cm) dhe Prurja (Q) në stacionet hidrometrike të realizuara për vitin 2023, në tabelën 16 janë prezantuar të dhënat për prurjet *Q (*m3/sec*)*, për stacionet monitouese hidrometrike të realizuara për vitin 2023, ndërsa në hartën 5 është prezantuar shpërndarja e rrjetit të hidrometeorologjik të Kosovës.

Tabela 15: Vlerat mesatare vjetore të nivelit H (cm) sipas stacioneve matëse 2023

Stacioni	Mes. (cm)
Gjonaj	236
Këpuz	150
Grykë	93
Drelaj	68
Klinë	48
Berkovë	123
Leposaviç	235
Vragoli	66
Mitrovicë	122
Orllan	31
Mramorë	16
Lupç i Epërm	54
Konçul	263
Viti	39
Hani i Elezit	81
Brod	32
Mlikë	70

Tabela 16: Vlerat mesatare vjetore të prurjeve Q (m3/sec) sipas stacioneve matëse 2023

Stacioni	Mes.(m3/sec)
Gjonaj	81.75
Grykë	8.488
Prizren	1.934
Brod	0.928
Mlikë	1.469



Harta 5: *Rrjeti Nacional Hidrometeorologjik i Kosovës*

3.2.3. Shfrytëzimi i resurseve ujore

Shpenzuesit më të mëdhenj të resurseve ujore janë operatorët e mëdha industriale, si `KEK-u`, `NeëCoFeronikli`, `Sharrcem-i`, etj. Pjesa më e madhe e tyre furnizohen me ujë nga liqenet akumuluese sipërfaqësore (tabela 17).

Tabela 17: Shfrytëzimi i ujit 2022-2023 nga ndërrmarrjet e mëdha industriale[7]

Shfrytëzuesit	**Sasia e shpenzuar e ujit (m^3/vit) 2022**	**Sasia e shpenzuar e ujit (m^3/vit) 2023**
Korporata Energjetike e Kosovës – KEK	18389642	16097678
Neë Co FERRONIKEL	882986	1552307
SHARRCEM	139061	107467
Gjithsej	**19411689**	**17757452**

[7] *Raportet vjetor per gjendjen e mjedisit, New Co Feronikeli*

3.3. Toka/dheu

MBZHR përkundër që ka punuar në ndërtimin e infrastrukturë ligjore për tokat dhe shfrytëzimin e tyre për bujqësi, hartimin e një mori strategjive dhe planeve të veprimit në këtë drejtim akoma nuk është krijuar një politikë konkrete dhe afatgjate për të mbrojtur tokat dhe për të siguruar qe ato të përdoren në mënyrë racionale, afatgjate e të qëndrueshëme dhe që do të shfrytëzohet nga brezat e rinjë.

Ligji Nr. 08/L-087 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-040 Për Rregullimin e Tokës rregullon në mënyrë progresive përdorimin e tokave, veçanërisht ato bujqësore.

Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për periudhën 2022-2028, ndër të tjera identifikon masat për rritjen e efikasitetit për ndërtimin e institucione të duhura, efektive publike dhe private, për të optimizuar përdorimin e burimeve të tokës, pyjeve dhe ujit në mënyrë të qëndrueshme dhe miqësore ndaj mjedisit. Prandaj, implementimi dhe zbatimi infrastrukturës ligjore dhe strategjive për bujqësi në mënyrën e drejtë do të ndikon që toka të shfrytëzohet më parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Në këtë drejtim mjaft me rëndësi për mbrojtjen dhe ruajtjen e tokave janë dokumentet e Planifikimit Hapësinorë, hartave zonale si dhe hartimi i planeve të zonave më përmbajtje të veçanta dhe me interes për shtetin që janë nën udhëheqjen e politikave të MMPHI.

3.3.1. Përdorimi i tokës në bujqësi

Pavarësisht tendencës që viteve të fundit tokës bujqësore t'i ndërrohet destinimi dhe të përdoret për qëllime tjera(privatizimi, ndërtimi apo shpronësimi etj), tendencë kjo që lidhet me zhvillimin e fundit ekonomik, ka një ndryshueshmëri jo të theksuar nga vitet paraprake.

Përdorimi i tokës bujqësore është i ndarë në dy grupe;

- Grupin e parë kemi tokën bujqësore të punueshme dhe
- Grupin e dytë përfshihen livadhet dhe kullotat që përdoren për kullotjen e bagëtive duke përfshirë edhe tokën e përbashkët.

Në vitin 2022 gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 420,482 ha që paraqet 23 ari tokë bujqësore për kokë banori.

Tabela 18: Trendi i përdorimit të tokës bujqësore 2018-2022 sipas kategorive

	2018 ha	2019 ha	2020 ha	2021 ha	2022 ha	Ndryshimi 2022/2021 në %	Pjesëmarrja në % 2022
Tokë e punueshme - ara	188,359	188,365 8,319	188,372 8,435	188,375 8,491	188,405	0.02	44.81
Nga e cila me perime në fushë të hapur	7,818				8,584	1.11	

(kulturë e parë)							
Nga e cila me perime në serra (kulturë e parë)	468	518	547	562	583	3.65	
Kopshte	1,003	1,122	1,133	1,089	1,080	-0.87	0.26
Plantacione të pemëve	7,687	9,244	10,029	10,144	10,377	2.30	2.47
Plantacione të vreshtave	3,272	3,367	3,437	3,471	3,472	0.03	0.83
Fidanishte	109	111	137	140	150	7.12	0.04
livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët)	218,152	217,932	217,102	217,107	216,998	-0.05	51.61
Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore	**418,582**	**420,141**	**420,210**	**420,327**	**420,482**	**0.04**	**100.00**

Nga gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore, pjesa më e madhe prej 51.6% apo 216,998 ha janë livadhe dhe kullota. Përqindje e lartë prej 44.8% ose 188,405 ha janë tokë e punueshme dhe pjesa tjetër prej 3.6% apo 15,079 ha janë: kopshtet, plantacionet e pemëve, vreshtave dhe fidanishtet.

3.3.2. Monitorimi i tokave

Deri me tani nuk është hartuar ndonjë program i veçantë për monitorimin e mjedisit, në të cilën do të ishte përfshirë edhe monitorimi i tokave në Kosovë. Në këtë drejtim akoma nuk kemi një sistem të monitorimit përkundër që janë dy institucione përgjegjëse për këtë qëllim.
Dy institucione kryesorë përgjegjëse për monitorimin e tokës siç janë: MBPZHR përmes Institutit Bujqësor dhe MMPHI përmes Institutit Hidrometeorologjik ende nuk kanë krijuar një sistem të monitorimit të tokave. Monitorimi i tokave kërkon një vullnet politik dhe profesional, në të cilën do të mundësonte që te kemi njohurit për strukturën, përbërjen, ndotjen dhe cilësinë e tokës.
Monitorimi i tokave është bërë vetëm sipas projekteve dhe rast për rast sipas kërkesave për vlerësim të ndikimit në mjedis (VNM).

Si përfitim kryesore nga monitorimi i tokave vlerësohet së do të kemi:

- Njohuri për treguesit kryesore të tokave bujqësore;
- Njohuri për përmbajtjen e metaleve të renda;
- Njohuri për shfrytëzimin apo mos shfrytëzimin e tokave për qëllime te caktuara;
- Njohuri për standardin e cilësisë së tokës etj.

Parametrat (treguesit) e mundshme dhe të kërkueshme për monitorimin e tokave që do të ishin të domosdoshme të kryhen si në aspektin bujqësor dhe ndotës, varësisht nga përgjegjësia institucionale, janë:
Tregusit fiziko-kimik: *Temperatura, pH, përbërja e grimcave të rërës, shtresa rrënjë mbajtëse, përshkueshmëria, kapaciteti ujëmbajtës;*
Treguesit kimikë inorganik: *konduktiviteti elektrik, N, P, K, aftësia e shkëmbimit kationik (Ca, Mg, Na, K), elementët gjurmë, (Mn, Zn, Cu, Fe), ushqyesit inorganik të asimilueshëm, hidrogjen karbonatet (HCO3 -), metalet e rënda (Cd, Cu, Ni, Fe, Pb, Mn), pesticidet;*
Lëndët organike: *masa organike (MO), mbetje e thatë, komponimet organike totale (TOC), pjelloria e tokës (C/N), pesticidet që mund të maten: aldrina, dieldrina, endrina, isodrina, diklordifeniltrikloretani (DDT), hidrokarburet policiklike aromatike (PAHet) antraceni, fenantreni, fluoranteni);*
Tregues biologjikë: *bioakumulatorë si alga, bimë uji dhe kafshë;*
Erozioni *dhe indikatorët që vlerësojnë erozionin e tokave nga mungesa e mbulesës bimore; monitorimi i shkallës së erozioni etj.*

3.3.3. Ndotja e tokave

Toka është një komponent jetik i kapitalit natyror, që zhvillohet biodiversitet dhe ofron shërbime jetike të ekosistemit. Toka është burim i prodhimit të ushqimit, pastrimit të ujit dhe ruajtjes së karbonit. Megjithatë, në vendet e BE-së janë potencialisht rreth 2.8 milion vende të kontaminuara dhe të pashëndetshëm[8].

Në vendin tonë si burime kryesore të ndotjes së tokave janë identifikuar: ndotësit bujqësor (preparatet kimike që përdoren në bujqësi), deponit e minierave dhe mbeturinave urbane, shkarkimi i ujërave urbane, transporti, ndotësit industrial, mbeturinat e rrezikshme dhe te pa sistemuara, degradimi fizik e sipërfaqeve tokësore, lokacionet e grumbullimit te makinave të dalura jashtë përdorimit etj (tabela 19).

Tabela 19: Burimet e ndotjes së tokës

Bujqësia	Mbeturinat komunale	Deponitë sanitare	Kimikatet dhe mbeturinat e rrezikshme	Industria	Minierat	Varrezat e makinave
Preparatet kimike për përdorim në bujqësi	Keq menaxhimi i mbeturinave urbane, deponive dhe ilegale	Deponit sanitare burim të ndotjes së tokave	Depozita jashtë çdo standardi	Mbetjet industriale	Rrjedha e ujërave ndotëse me metale të renda	Deponite e makinave te vjetra dhe auto serviset
Janë përdorur rreth 80.882 ton fertilizues të llojeve të	Gjat vitit 2023 janë identifikuar rreth 400 vend hedhje ilegale të mbeturinave	-7 deponi sanitare, - 3 stacion tranfere, dhe - 1 deponi e paautorizuar	Dhjetëra lokacione të kemikateve dhe mbeturinave të rrezikshme të menaxhuara në	Deponi të menaxhuara jashtë standardeve në zonat idnustriale	Deponi te mbetjeve minerare dhe industriale që nuk janë rehabilituar	Shkarkimi i vajrave të përdorura dhe mbetjeve tjera nga

[8] https://www.eea.europa.eu/en/topics/in-depth/soil

ndryshme, ndërsa me pesticide janë trajtuar 122. 752 ha tokë bujqësore	komunale dhe te mbeturinave te ndërtimit të pa menaxhuara	nga MMPHI, që nuk menaxhohen sipas standardeve	kushte të papërshtatshme	aktivis si KEK, SharCem, NeëCoFeronikel, etj.	ende	600 vend grumbullime të makinave te vjetra

Ndotja e tokave në Kosovë ka nderlidhshmëri me aktivitete industriale e minerare, veçanërisht në zona të caktuara ku ka shtrirje industria minerare, industriale dhe termocentraleve. Presioni i ndotjes së tokave vijë edhe nga mbeturinat e rrezikshme të cilat nga MMPHI janë evidentuara në 17 lokacione në gjithë vendin. Pastrimi i këtyre vendeve të kontaminuar akoma nuk ka gjetur zgjidhje të përhershme.

Si konkluzion theksojmë se si institucionet përgjegjëse për ngritjen e një sistemi të njësuar dhe integral të mbrojtjes dhe monitorimit të tokave është MMPHI dhe MBZHR. Një vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet ngritjes së sistemit të monitorimit e cila do të identifikonte çdo tregues relevant për tokat. Grumbullimi, analizimi, raportimi dhe vlerësimi i të dhënave për treguesit për tokën, do të janë çështjet kryesore në këtë proces.

Në saje të identifikimit dhe vlerësimit të treguesve për tokën, institucionet përgjegjëse do të fokusohen në gjetjen e mekanizmave për të përmirësuar dhe parandaluar ndotjen e mëtutjeshëm të tokave. Si përfundim, krahas përgatitjes së planeve dhe politikave të veprimit për mbrojtjen e tokave ndaj ndotjes, degradimi apo betonimi, institucionet qendrore dhe lokale duhet planifikuar edhe investime në zbatimin e këtyre planeve apo politikave.

3.4. Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë është një nga sfidat kryesore si për nivelin qendror ashtu edhe për nivelin lokal të qeverisjes. Kur flasim për menaxhimin e mbeturinave komunale bazuar në legjislacionin në fuqi bie direkt mbi përgjegjësinë e komunave. Ky proces përfshin mbledhjen, transportimin dhe trajtimin e integruar të mbeturinave. Këto mbeturina prodhohen nga aktiviteti i përditshëm i qytetarëve dhe bizneseve.

Ekziston një bazë solide e legjislacionit që e rregullon menaxhimin e mbeturinave e gjithashtu dokumente si "Strategjia dhe Plani i Veprimit" për menaxhimin e integruar të mbeturinave në Kosovë, ndërkaq në nivelin lokal, të gjitha komunat i kanë miratuar planet komunale 5 vjeçare të menaxhimit të mbeturinave dhe po ashtu rregulloret për menaxhimin e mbeturinave. Në këto dokumente planifikuese janë paraparë një mori objektiva dhe aktivitete. Përkundër angazhimeve per përmasimin e gjendjes se menaxhimit te mbeturinave ,ende haset në vështirësi të natyrave të ndryshme.

AMMK vazhdimisht bën monitorimin e gjendjes në këtë sektor dhe mbi bazën e të gjeturave vlerëson se ka një përmirësim të gjendjes së menaxhimit të mbeturinave, pothuajse në të gjitha komunat. Kështu, bazuar në të dhënat e raportimeve nga

komunat, monitorimeve në teren ka vlerësuar se ka ngritje të nivelit të mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave, rritje të arkëtimit, largimin dhen pastrimin e deponive ilegale dhe po ashtu përmirësim në fushën e plotësimit të obligimeve ligjore nga niveli lokal.

Nga niveli qendror ka iniciativa për zbatim e projekteve të parapara me strategji dhe plan të veprimit, siç janë studimet e fizibilitetit për deponitë sanitare, aplikimi i një takse për qeset e plastikes, është kryer hulumtimi i gjendjes sa i përket fillimit të zbatimit të sistemit të rikthimit të depozitave për shishet dhe kanaqet dhe fillimi i zbatimit të këtij objektivi, ekonomia qarkore, etj.

Gjithashtu bashkëpunimi me donatorë të jashtëm që janë duke na mbështetur në ngritjen e kapaciteteve, investimeve direkte në pajisje teknike dhe softuerike për implementimin e projekteve dhe aktiviteteve tjera në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.

AMMK kërkon nga akterët përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave komunale të nisin iniciativa pozitive që ndikojnë drejtë menaxhimit të integruar të mbeturinave, në radhë të parë aplikimin e modelit **3R** (reduktimit të gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimit të tyre, si dhe riciklimit), pasi është i njohur fakti se vetëm këto nisma të menaxhimit të mbeturinave mund të ndikojnë në qëndrueshmëri dhe përfitime tjera qofshin ato mjedisore, por edhe ekonomike dhe sociale nga sektori i mbeturinave.

Një spektër tjetër i mbeturinave për të cilat ende nuk ka menaxhim të mirëfilltë janë mbeturinat e rrezikshme, një pjesë e mbeturinave spitalore, mbeturinat shtazore, mbeturinat e ndërtim - demolimit, gomat mbeturinë, vajrat mbeturinë, etj., gjendja e të cilave vazhdon të paraqet një sfidë të madhe për mirëqenien e mjedisit.

Natyrisht se për këto lloje mbeturinash kërkohen analiza dhe hulumtime konkrete, në radhë të parë për të pasur një pasqyrë më të qartë të gjendjes së tyre dhe po ashtu investime specifike në mënyrë që të futet nën kontroll të plotë menaxhimi i tyre, ashtu që të përmirësohet gjendja e tyre dhe rrjedhimisht të eliminohet edhe ndikimi negativ në shëndet dhe në mjedis.

Bazuar në monitorimet e rregullta të AMMK-s vlerësohet se gjendja e deponive sanitare për deponimin e mbeturinave komunale tashmë është përkeqësuar jashtë mase dhe pothuajse të gjitha deponitë e kontrolluara (5 regjionale dhe 2 komunale) janë në prag të kolapsit.


Kjo gjendje ka ardhur si pasojë e shumë faktorëve, por me theks të veçantë nga menaxhimi jo adekuat i tyre, mungesa e investimeve, tejkalimi i kapaciteteve planifikuese për deponimin e mbeturinave, etj.

Menaxhimi i mbeturinave industriale dhe i deponive industriale aktive, por edhe atyre të trashëguara nga aktivitetet minerare dhe industriale, paraqesin një problematikë specifike për mjedisin. Gjendja e tyre nuk është plotësisht e njohur, andaj është e domosdoshme që në të ardhmen të bëhet një vlerësim dhe të hartohen plane dhe projekte për menaxhimin dhe rehabilitimin e tyre.

Duhet theksuar se sistemi aktual i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë nuk ofron të dhëna të plota për gjenerimin, mbledhjen, trajtimin dhe eliminimin e mbeturinave, dhe kjo paraqet një sfidë edhe për vlerësimin e gjendjes në këtë sektor.

Andaj, kërkohet që akterët përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave, të ndërtojnë sisteme të mbajtjes së të dhënave, dhe të raportojnë mbi gjendjen e menaxhimit të mbeturinave.

Raportimi i rregullt dhe i verifikuar mbi menaxhimin e mbeturinave është rruga më e sigurtë për ta njohur dhe vlerësuar drejtë gjendjen në këtë sektor dhe mbi bazën e gjetjeve të mundohemi të ndërmarrim masa dhe veprime konkrete për përmirësimin e gjendjes në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.



OBJ	KOMUNA	VENDBANIMI	EMRI_I_OBJ	SIP_HA
1	Gjilan	Velekincë	Deponi regjionale	12 ha
2	Mitrovicë	Koshtovë	Deponi regjionale	7 ha
3	Pejë	Sferk	Deponi regjionale	3.6 ha
4	Prishtinë	Mirash	Deponi regjionale	6.8 (40) ha
5	Dragash	Brrut	Deponi komunale	2 ha
6	Prizren	Landovicë	Deponi regjionale	25 ha
7	Podujeve	Dumnicë e Poshtme	Deponi komunale	5 ha
8	Ferizaj	Gerlicë	Stacion i transferit	
9	Drenas	Çikatove	Stacion i transferit	
10	Gjakove	Lagja e romve	Stacion i transferit	

Harta 6: *Deponitë regjionale, komunale dhe stacionet e transferit*

3.4.1. Gjenerimi i mbeturinave komunale

Gjenerimi i mbeturinave është problem global, dhe sfidat e tij rriten me rritjen e popullsisë dhe urbanizimit. Për të siguruar një mjedis të qëndrueshëm, është e rëndësishme të kuptojmë dhe të ndërmerren veprime efektive për të menaxhuar dhe reduktuar gjenerimin e mbeturinave në mënyrë që të ulet ndikimi negativ në mjedis.

Gjenerimi i mbeturinave është procesi ku prodhohen dhe akumulohen mbeturina, të cilat pastaj duhet të trajtohen në mënyrë të përshtatshme për t'i zvogëluar ndikimin negativ në mjedis dhe shëndetin publik. Gjenerimi i mbeturinave është një problem i rëndësishëm për shoqërinë për shkak të rritjes së prodhimi industrial dhe konsumit.

Në mënyrë që të menaxhohen efektivisht mbeturinat, shoqëria dhe institucionet përgjegjëse duhet të marrin masa të ndryshme, si:

- **Riciklimi**: klasifikimi dhe përpunimi i materialeve për të krijuar një resurs të ri;
- **Zvogëlimi i mbeturinave**: reduktimi i prodhimit të mbeturinave duke përdorur produkte të riciklueshme dhe duke minimizuar mbeturinat;
- **Ekonomia qarkore**: përdorimi i mbeturinave si burim për të prodhuar produkte të reja, duke promovuar ekonominë e ripërdorimit;
- **Trajtimi i sigurt**: trajtimi i mbeturinave toksike dhe të rrezikshme në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me ligjet dhe standardet e mjedisit;
- **Ndërgjegjësimi dhe edukimi**: informimi i publikut për rëndësinë e menaxhimit të mbeturinave dhe angazhimi për praktika të qëndrueshme.

AMMK çdo vit mbledhë të dhëna për sasinë e mbeturinave komunale të gjeneruara sipas komunave në nivel vendi. Të dhënat për sasinë e mbeturinave të gjeneruara në nivel të komunave janë marrë nga raportimi i komunave në AMMK.
Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhënat e gjenerimit të mbeturinave komunale për komunat për vitin 2021, 2022 dhe 2023.

Edhe përkundër faktit se raportimi nuk ka qenë i plotë, AMMK ka bërë vlerësimin e të dhënave dhe vlerësohet se ka një trend pothuajse linear të sasisë së mbeturinave të gjeneruara për kokë banori në Kosovë.


Tabela 20: Gjenerimi i mbeturinave komunale kg\banor\vit (2021, 2022 & 2023)

[9]Komuna	Grumbullimi i mbeturinave ton/vit	Gjenerimi kg/banorë/vit	Grumbullim i mbeturinave ton/vit	Gjenerimi kg/banorë/vit	Grumbullimi i mbeturinave ton/vit	[10]Gjenerimi kg/banorë/vit
	2021	2021	2022	2022	2023	2023
Prishtinë	76,339.00	212.13	71,515.00	197.06	89,840.00	243.94
Drenas	7,458.10	150.33	7,209.77	143.61	10,685.00	220.86
Fushë-Kosovë	17,626.83	253.81	17,972.20	241.75	18,913	236.88
Graçanicë	4,503.26	252.8	5,453.49	258.43	5,022.00	318.32
Lipjan	13,053.12	243.47	13,279.00	239.47	13,213.00	251.08
Obiliq	7,152.62	390.52	7,138.20	381.58	7,217.00	382.93
Podujevë	18,139.50	300.22	17,090.00	284.15	16,106.00	293.95
Mitrovicë	21,967.00	306.06	25,995.00	364.82	25,924.00	291.91
Skënderaj	7,464.06	208.55	7,098.00	179.5	8,683.00	203.22
Vushtri	19,596.85	209.53	19,456.00	278.46	20,593.00	293.27
Mitrovica V.	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Zveçan	2,430.00	363.15	0	0	0	0
Zubin-Potok	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Leposaviq	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Pejë	36,063.00	391.97	36,164.00	376.12	33,077.00	327.78
Istog	16,256.30	459.88	11,892.00	374.2	11,569.00	240.60
Klinë	9,758.70	258.9	9,173.00	242.81	7,738.00	171.81
Prizren	49,839.86	235.31	49,409.00	259.41	49,166.00	243.02
Suharekë	15,181.54	265.98	13,776.00	230.67	13,484.00	174.12
Malishevë	10,596.00	180.38	10,243.70	169.15	9,968.00	155.12
Rahovec	14,426.90	200.35	14,611.00	199.78	14,051.00	190.99
Dragash	7,952.00	313.77	7,490.00	246	7,479.00	236.75
Mamushë	1,080.00	243.96	1,080.00	229.81	1,200.00	252.22
Ferizaj	23,476.48	283.74	27,995.50	281.13	24,427.00	195.48
Kaçanik	3,942.74	170.7	5,859.00	181.39	4,770.00	124.9
Shtime	4,486.51	224.51	4,621.00	225.31	4,691.00	204.19
Hani i Elezit	2,313.31	257.36	2,300.00	241.77	2,016.00	208.93
Shtërpca	1,827.34	289.26	0	0	1,720.00	133.66
Gjilan	25,124.14	298.79	25,398.00	328.11	25,557.00	374.41
Kamenice	5,493.55	225.01	5,297.50	205.75	5,061.00	181.69
Viti	6,351.20	209.63	6,366.00	192.31	6,451.00	252.37
Novoberde	2,181.15	444.77	2,149.00	406.64	1,076.00	393.05
Partesh	563.36	138.42	0.00	0.00	0.00	0.00
Kllokot	925.48	232.28	0.00	0.00	0.00	0.00
Ranillug	1,118.33	301.58	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjakovë	25,585.22	322.61	24,801.00	305.02	22,544.00	237.97
Deçan	8,298.40	176.69	8,316.00	160.88	7,211.00	137.21
Junik	818.09	107.41	920	126.84	938.00	120.28
Nivel vendi	**469,389.94**	**9,123.83**	**460,068.36**	**7,551.93**	**470,390.00**	**235.25**

Duhet cekur se ky rezultat për gjenerimin e mbeturinave bazohet vetëm në sasinë e mbeturinave të grumbulluara nga operatorët për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave, pra nuk përfshihet e tërë sasia e mbeturinave që realisht gjenerohen në komuna.

[9] Disa komuna nuk kanë raportuar në AMMK dhe rrjedhimisht nuk janë pasqyruar të dhena.

[10] Të dhënat e prezantuara në këtë tabelë i referohen sasisë së mbeturinave të grumbulluara për vitin raportues për komuna dhe nuk e përfshinë sasinë vjetore të gjeneruar.



Harta 7: *Gjenerimi i mbeturinave sipas komunave 2022-2023*

3.4.2. Analiza e përbërjes së mbeturinave komunale

Analiza e përbërjes së mbeturinave komunale është e një rëndësie të veçantë, kjo pasi për nivelin qendror e po ashtu edhe për nivelin lokal ofron njohje më të mirë të gjendjes së mbeturinave dhe lehtëson hartimin dhe monitorimin e zbatimit të strategjisë kombëtare, hartimin e planeve afatgjate për menaxhimin e mbeturinave, si dhe ofron qasje me të lehtë në implementimin e programeve si të riciklimit, kompostimit, duke synuar në minimizimin e gjenerimit të mbeturinave.

Kjo analizë e përbërjes së mbeturinave është tregues i llojeve të mbeturinave që gjenerohen gjatë një viti në aspektin kohor, sasior dhe cilësor, duke u bazuar në sasinë e përgjithshme të mbeturinave që gjenerohen brenda vitit.

Anliza e përbërjes së mbeturinave komunale është realizuar përgjatë një viti, tetor 2021 deri në nëntor 2022, e realizuar në 7 regjionet e Kosovës, në komunat: Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Gjakovë, Mitrovica e Jugut, Gjilan dhe Pejë. Mostrat janë marrë në 4 zona të qyteteve, duke përfshirë banimet kolektive, individuale, kategoritë biznesore dhe ato të përziera (me banim kolektiv, individual e biznesor).

Operatorët e grumbullimit të mbeturinave në këto 7 regjione janë: KRM "Pastrimi", KRM "Çabrati", KRM "Uniteti", KRM "Ambienti", KRM "Ecohigjiena", KRM "Pastërtia", KRM "EkoRegjioni". Aktualisht, pothuajse të gjitha mbeturinat që gjenerohen në këto regjione-komuna deponohen në deponitë e kontrolluara regjionale dhe komunale.

Hulumtimi dhe analiza e përbërjes së mbeturinave komunale është mundësuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, në kuadër të projektit "Shërbime të Qëndrueshme Komunale-SMS" përmes Environmental Sustainable Solution "ESS L.L.C", drejtorive të Shërbimeve Publike të Komunave përkatëse dhe 6 kompanive regjionale që bëjnë mbledhjen dhe transportin e mbeturinave komunale.

Tabela 21: Përbërja e mbeturinave[11]

Përbërja e mbeturinave	Faza I	Faza II	Faza III	Totali
Mbeturina organike	29.2%	32.9%	29.3%	30.4%
Mbeturina të gjelbëra	5.0%	4.4%	4.2%	4.5%
Tetrapak	2.1%	2.5%	3.2%	2.6%
Plastikë	18.7%	19.7%	20.3%	19.6%
Letër / karton	16.3%	15.4%	13.6%	15.1%
Tekstil	4.9%	4.4%	5.0%	4.8%
Metale	1.3%	1.5%	2.7%	1.8%
Qelq	4.5%	5.8%	6.2%	5.5%
Dru	0.9%	1.0%	2.5%	1.5%

[11] *Raporti i analizës së përbërjes së mbeturinave në 7 regjionet e Kosovës, ESS L.L.C, 2022*

MKD	2.0%	2.9%	4.3%	3.1%
Mbeturina të rrezikshme	0.2%	0.2%	0.3%	0.2%
Pampersa	4.6%	3.5%	3.7%	4.0%
Mbeturina të imëta	10.3%	5.7%	4.7%	6.9%




Figura 17: *Përbërja e mbeturinave në Kosovë*

3.4.3. Deponimi i mbeturinave komunale në deponi sanitare

Deponimi i mbeturinave është një aspekt kyç i menaxhimit të mbeturinave dhe është i rëndësishëm për të siguruar që ndotja e mjedisit të zvogëlohet dhe të ruhen burimet natyrore. Mirëpo, kjo është forma më tradicionale e trajtimit të mbeturinave dhe duhet të bëhen përpjekje që mbeturinat t'i nënshtrohen trajtimeve tjera paraprake dhe vetëm ato sasi që nuk mund eventualisht të trajtohen të deponohen.

Në deponi mbeturinat e përziera vendosen dhe i nënshtrohen disa proceseve si: shpërndarja në shtresa, ngjeshja, mbulimi me shtresë dheu etj., në mënyrë që të parandalohet kundërmimi, minimizimi i hapësirës për deponim, ruajtja nga zjarret etj.

Mbeturinat komunale që gjenerohen nga popullata grumbullohen nga operatorët e mbledhjes dhe transportit të mbeturinave dhe rregullisht deponohen në 7 deponitë ekzistuese të cilat menaxhohen dhe kontrollohen. Prej tyre 5 deponi janë regjionale dhe 2 tjera komunale.

Në asnjërën nga këto deponi nuk përmbushën pothuajse as standardet minimale për deponi. Nuk ka sisteme të instaluara të kapjes së gazrave të deponisë (Metanit), nuk ka trajtim të ujërave të deponisë, ka prezencë të personave të pa autorizuar, nuk mirëmbahen deponitë dhe deri më tani nuk ka investime konkrete për të rritur sigurinë dhe mirë operimin e këtyre deponive. AMMK vlerëson se mbi 90% e sasisë së mbeturinave të gjeneruara brenda një viti në Kosovë deponohet në këto deponi të menaxhuara, kurse pjesa tjetër përfundon në vend hedhje ilegale si dhe një pjesë mblidhet nga sektori joformal për qëllime të tregtimit. Një zvogëlim prej 9,771 tona krahasuar me vitin 2022, apo 2% më pak (figura 18).




Figura 18: *Deponimi i mbeturinave komunale në deponit sanitare në Kosovë, 2018-2023*




Figura 19: *Trendi i deponimit të mbeturinave komunale në Kosovë 2018-2023*

Sasia më e madhe e mbeturinave gjatë vitit 2023 është deponuar në deponinë sanitare në Mirash (Prishtinë) 191,644.72 ton, kurse sasia më e vogël në deponinë sanitare në Dragash 7,479.00 ton.

Në deponitë sanitare të menaxhuara nga KMDK-ja: Mirashi (Prishtinë), Dumnicë (Podujevë), Velekincë (Gjilan), dhe Landovicë (Prizren), deponimi i mbeturinave në vitin 2023 ka shënuar një ulje prej 6,841 ton apo 1.8% më pak krahasuar me vitin 2022.

Ndërkaq në deponinë sanitare rajonale në Mitrovicë (Gërmovë) në vitin 2023 janë deponuar 54,063.48 ton apo 2.3% më shumë mbeturina se në vitin 2022, kurse në deponinë sanitare në Pejë në vitin 2023 janë deponuar 51,882.50 ton apo 7.4% më shumë krahasuar me vitin 2022.

Në deponitë sanitare të Dragashit dhe të Podujevës, deponohen mbeturinat e gjeneruara vetëm në komunat gjegjëse dhe gjatë vitit 2023 janë deponuar 7,479.00 ton, respektivisht 17,239 ton.

3.4.4. Trajtimi i mbeturinave

Trajtimi i mbeturinave përfshin proceset dhe teknologjitë e përdorura për të përpunuar dhe trajtuar mbeturinat në mënyrë që të minimizohen ndotja e mjedisit dhe të ruhen burimet natyrore.

Disa nga metodat dhe teknologjitë kryesore të trajtimit të mbeturinave janë:

- **Riciklimi**- materialet e riciklueshme të mbledhura përsëri përdoren për të prodhuar produkte të reja, duke zvogëluar nevojën për burime të reja dhe ndotjen e mjedisit;
- Kompostimi- proces i kalbjes së mbeturinave organike dhe rikthimi i materialeve minerale në tokat e punueshme;
- **Incenerimi me prodhim të energjisë dhe ngrohjes**- mbeturinat digjen në temperatura të larta për të prodhuar energji elektrike dhe nxehtësi. Kështu furnizohen konsumatorët me energji elektrike dhe ngrohje, duke kufizuar nevojën për burime të tjera energjetike.
- **Deponimi-** mbeturinat që nuk mund të riciklohet, kompostohet ose incenerohet, përfundon në landfill.
- **Trajtimi i mbeturinave të rrezikshme përmes teknologjive specifike-** mbeturinat e rrezikshme si kimikate, bateri të shpërndarura dhe pajisje elektronike trajtohen përmes pajisjeve të specializuara për të siguruar që toksinat dhe materiale të rrezikshme të izoluara dhe të përpunuara në mënyrë të sigurt.

Menaxhimi përmes teknologjive të avancuara të mbeturinave është një aspekt kyç i menaxhimit të mbeturinave, ku synohet që të zvogëlohet ndotja e mjedisit dhe të përdoren burime të rishfrytëzueshme në mënyrë më efikase.

Bazuar në të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në anketimet e rregullta që janë kryher lidhur me trajtimin e mbeturinave komunale[12],

[12]*ASK, Anketa e Mbeturinave të Trajtuara, 2022*

ku janë përfshirë akterët të cilët merren me trajtim të mbeturinave janë pasqyruar në përqindje sasia e secilës kategori të mbeturinave që është trajtuar në grafikonin në vijim.

Siç shihet pra në grafikon, sasia më e madhe e mbeturinave të trajtuara i takon mbeturinave të gjeneruara nga ekonomitë familjare, të cilat janë trajtuar përmes deponimit klasik, të pasuar nga mbeturinat e letrës dhe kartoni, plastikës etj. Format e trajtimit kanë qenë deponimi, sterilizimi, riciklimi, respektivisht ndarja dhe klasifikimi i tyre.




Figura 20: *Trajtimi i mbeturinave komunale në Kosovë*

3.4.5. Deponitë ilegale

Deponitë e paligjshme janë një problem global, madje edhe për vendet e zhvilluara e më të theksuara janë në vendet e pazhvilluara dhe ato në zhvillim. Hedhjet ilegale të mbeturinave janë të ndërlidhura ngushtë me mungesën e infrastrukturës përkatëse, varfërisë dhe vetëdija e ulët e komunitetit.

Hedhjet ilegale të mbeturinave në vende të paligjshme paraqesin rreziqe të rëndësishme mjedisore, shëndetësore dhe estetike për zonën dhe ekosistemin. Në këto vend hedhje ilegale zakonisht gjenden mbeturina të tilla si: mbeturinat shtëpiake, mbeturinat e ndërtimit, mbetjet industriale ose materialet e rrezikshme, mbetje shtazore etj. Si pasojë, sjellin ndotjen e tokës, ujërave dhe sidomos ujërave nëntokësore dhe degradimin e pamjeve natyrore, duke ndikuar negativisht në jetën e bimëve dhe kafshëve.

Në anën tjetër këto vende të ndotura tërheqin dëmtues si brejtësit dhe insektet, të cilët mund të përhapin sëmundje tek njerëzit. Shpesh ndodhë që këto mbeturina të digjen dhe për pasojë kemi përhapjen e tymit duke rreziku drejtpërdrejte shëndetin.

Hedhja e mbeturinave në mënyrë të paligjshme është një vepër e dënueshme me legjislacionin në fuqi dhe mund të rezultojë me gjoba, dënime dhe veprime ligjore kundër atyre që janë përgjegjës. Në anën tjetër pasqyron edhe komunitetin e zonës dhe mund të ulë vlerat e pronës në zonat e prekura.

Akterët përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit duhet të angazhohen për të parandaluar hedhjen e paligjshme përmes fushatave të ndërgjegjësimit të publikut, zbatimit më të rreptë të legjislacionit dhe ofrimin e kushteve për trajtimin adekuat të mbeturinave sidomos atyre më specifike. Për arsye se fushatat dhe aktivitetet për pastrimin e këtyre zonave janë të kushtueshme, kërkojnë kohë dhe shpesh kërkojnë pajisje dhe ekspertizë të specializuar.

Në muajin maj 2024 me kërkesë të AMMK-së komunat kanë bërë regjistrimin e deponive ilegale dhe regjistrimit iu kanë përgjigjur 28 komuna të cilat edhe i kanë raportuar të dhënat në AMMK. Vlerësohet së në disa komuna ka pasur përmirësim të gjendjes sa i përket numrit të deponive ilegale, kurse në disa të tjera ka pasur përkeqësim të gjendjes. Deponitë janë regjistruar në 3 kategori: të vogla, të mesme dhe të mëdha. Për më shumë të dhënat janë prezantuar në tabelën në vijim.

Tabela 22: Numri i deponive ilegale të identifikuara, viti 2022 dhe 2023 sipas komunave

2022					2023				
	Deponitë ilegale sipas madhësisë			Deponi ilegale gjithsej 2022		Deponitë ilegale sipas madhësisë			[13]Deponi ilegale gjithsej 2023
Komuna	Deponi të vogla (1-5 thasë mbeturinash 200 l)	Deponi të mesme (6-20 thasë mbeturinash 200 l)	Deponi të mëdha (>20 thasë mbeturinash 200 l)		**Komunat**	Deponi të vogla (1-5 thasë mbeturinash 200 l)	Deponi të mesme (6-20 thasë mbeturinash 200 l)	Deponi të mëdha (>20 thasë mbeturinash 200 l)	
Prishtinë	9	1	4	14	**Prishtinë**	0	0	3	3
Gllogoc	6	3	1	10	**Gllogoc**	5	9	3	17
Fushë-Kosovë	0	3	6	9	**Fushë-Kosovë**	1	3	5	9
Graçanicë	3	5	8	16	**Graçanicë**	2	4	1	7
Lipjan	12	23	51	86	**Lipjan**	15	35	30	80
Obiliq	1	2	5	8	**Obiliq**				0
Podujevë	1	0	0	1	**Podujevë**				
Mitrovicë	5	2	7	14	**Mitrovicë**	6	6	4	16

[13] Regjistrimin dhe raportimin e deponive ilegale në AMMK, 12 komuna nuk e kanë kryer dhe rrjedhimisht nuk i kemi të dhënat për këto komuna.

Skenderaj	1	2	1	4	**Skenderaj**	3	13	10	26
Vushtrri	1	1	0	2	**Vushtrri**	1	1	1	3
Mitrovicë e V.	8	1	0	9	**Mitrovicë e V.**				
Zveçan	7	7	12	26	**Zveçan**				
Zubin-Potok	9	5	1	15	**Zubin-Potok**				
Leposaviq	17	13	10	40	**Leposaviq**				
Pejë	5	4	4	13	**Pejë**	7	9	5	21
Istog	4	5	1	10	**Istog**	1	5	1	7
Klinë	10	12	11	33	**Klinë**	3	7	8	18
Prizren	9	3	2	14	**Prizren**	12	2	0	14
Suharekë	16	17	7	40	**Suharekë**	5	4	0	9
Malishevë	41	30	11	82	**Malishevë**				
Rahovec	3	3	2	8	**Rahovec**	2	3	2	7
Dragash	2	17	14	33	**Dragash**	0	11	27	38
Mamushë	5	0	5	10	**Mamushë**	2	2	2	6
Ferizaj	5	4	3	12	**Ferizaj**	0	5	1	6
Kaçanik	3	3	8	14	**Kaçanik**	8	3	4	15
Shtime	6	6	11	23	**Shtime**	0	6	5	11
Han i Elezit	2	1	2	5	**Han i Elezit**	3	4	1	8
Shtërpcë	17	14	8	39	**Shtërpcë**	10	7	5	22
Gjilan	35	11	2	48	**Gjilan**				
Kamenicë	3	6	3	12	**Kamenicë**	0	3	6	9
Viti	0	0	0	0	**Viti**				
Novobërdë	29	3	0	32	**Novobërdë**	0	3	1	4
Partesh	4	5	7	16	**Partesh**				
Kllokot	1	3	3	7	**Kllokot**				
Ranillug	2	1	1	4	**Ranillug**				
Gjakovë	2	7	17	26	**Gjakovë**	2	6	28	36
Deçan	2	4	2	8	**Deçan**	5	4	1	10
Junik	2	1	0	3	**Junik**	1	0	0	1
Gjithsej	**288**	**228**	**230**	**746**	**Gjithsej**	**94**	**155**	**154**	**403**

3.4.6. Mbeturinat spitalore

Mbeturinat spitalore trajtohen përmes procesit te sterilizimit në 7 sterilizator të vendosur në 7 spitale regjionale. (përmes sterilizimit trajtohen kryesisht: shiringat, infuzionet, fashat dhe pajisje të ndryshme të përdorura në trajtime shëndetësore. Këto mbeturina pas trajtimit përmes sterilizimit dhe imtësimit vendosen në kontejner të mbeturinave të ngurta urbane dhe deponohen në deponi.)

Një spektër tjetër i mbeturinave (kryesisht barnat me afat te skaduar, suplemente të ndryshme etj.) asgjësohen në furra për shkrirjen e metaleve në disa kompani të pajisura me leje përkatëse mjedisore.

Një spektër tjetër i mbeturinave janë ato patologjike (placenta, embrione, amputime, lëngje trupore etj.) qendrat spitalore përmes kompanive te kontraktuara i groposin ato në varreza dhe i gëlqerosin për t'i dezinfektuar.

Mbeturinat kimike të përdorura në kujdesin shëndetësor nuk ndahen dhe nuk kanë ndonjë trajtim specifik siç e kërkon legjislacioni, dhe supozohet se hidhen apo menaxhohen keq. Mbeturinat farmaceutike (medikamente citostatike dhe citotoksike) të përdoruara në kujdesin shëndetësor, sasia e madhe e tyre janë të deponuara në depon qendrore në Prishtinë, një pjese ruhet edhe në spitale regjionale.

Prej të dhënave të raportuara dhe të vlerësuara nga këto qendra të trajtimit të mbeturinave spitalore, në vitin 2023 shohim një rritje prej 108,892.46 kg më shumë mbeturina që janë trajtuar-sterilizuar, respektivisht 1,029,672.71 kg mbeturina, apo 10% më shumë krahasuar me vitin 2022.

Sasia më e madhe e këtyre mbeturinave edhe gjatë vitit 2023 sikurse edhe në vitet paraprake është trajtuar në impiantin i cili operon në QKUK në sasi prej 756,882.00 kg, e pasuar nga impianti në Prizren me një sasi prej 74,262.00 kg, kurse sasia më e vogël është trajtuar në impiantin e vendosur në Qendrën Spitalore në Vushtri me vetëm 2,541.21 kg mbeturina të trajtuara (tabela 23).

Tabela 23: Sasia e mbeturinave spitalore të sterilizuara në 8 qendrat spitalore rajonale

Impianti	2018	2019	2020	2021	2022	2023
	kg	kg	kg	kg	kg	kg
Prishtinë	360,819.10	487,169.60	766,347.40	465,335.00	610,564.20	756,882.00
Prizren	100,175.70	97,195.20	96,227.50	96,290.80	106,782.70	74,262.00
Pejë	49,215.00	45,720.00	50,480.00	47,560.00	44,678.00	44,488.00
Ferizaj	35,465.90	39,215.00	37,664.40	39,934.30	38,914.80	30,014.50
Gjilan	26,460.40	29,859.80	40,748.00	42,046.00	39,689.00	47,687.00
Gjakovë	2,951.00	3,357.00	3,159.00	3,284.00	1,288.00	0.00[14]
Mitrovicë	72,323.00	85,149.00	68,214.00	67,174.00	76,250.00	73,798.00
Vushtrri	2,504.00	2,580.35	632.61	1,185.74	2,613.55	2,541.21
Gjithsej	**649,914**	**790,245**	**1,063,472**	**762,809**	**920,780**	**1,029,672**

[14] *Gjatë vitit 2023 sterilizatori në Spitalin Rajonal në Gjakovë nuk ka operuar fare për shkaqe defekti dhe sasia e mbeturinave nga kjo qendër është trajtuar në sterilizatorin në Pejë dhe në Ferizaj.*

3.4.7. Mbeturinat industriale

Rezultatet nga anketa e mbeturinave industriale[15] tregojnë për trendin e rritjes progresive të gjenerimit të mbeturinave industriale që nga viti 2019 (shih grafikonin në vijim). Kështu në vitin 2022 është shënuar një rritje prej 34% krahasuar me vitin 2021 kur janë gjeneruar 2,214,928.00 ton mbeturina industriale, respektivisht 3.5% më shumë krahasuar me vitin 2020.

Gjatë vitit 2022 janë përpunuara gjithsej 3,390,096.00 ton mbeturina industriale. Format e përpunimit kanë qenë: deponimi, djegia dhe riciklimi. Konkretisht 280,042.00 ton mbeturina industriale janë deponuar, janë djegur 36,458.00 ton, si dhe janë ricikluar 2,805,042.00 ton, kurse 234,681.00 ton janë dërguar diku tjetër (figura në vijim).

Të dhënat e vitit 2022 tregojnë se sasia më madhe e mbeturinave të gjeneruara sipas sektorëve të industrisë ishin tek: Sektori D (Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar) me 2,795,809.00 ton dhe Sektori i dytë me radhë ka qenë Prodhimtaria me 335,452.00 ton.




Figura 21: *Gjenerimi dhe trajtimi i mbeturinave industriale në Kosovë*

[15] *ASK, Anketa e Mbeturinave Industriale, për vitin 2022*




Figura 22: *Trendi i gjenerimit të mbeturinave industriale në Kosovë 2018-2022*

3.4.8. Importi dhe eksporti i thasëve dhe qeseve të plastikës si dhe i mbetjeve

Ndotja e mjedisit me mbetje të plastikës është një dukuri mjaftë shqetësuese me të cilën po ballafaqohet vazhdimisht vendi. Ndotjes së mjedisit me mbetje të plastikës i kontribuon sidomos përdorimi i madhë i qeseve të plastikes njëpërdorimshe.

Prania e qeseve gjithandej në mjedisin tonë rrethues është një fenomen shumë shqetësues dhe padyshim se në këtë dukuri negative kontribuon edhe importi dhe përdorimi i madh i qeseve të plastikës.

Prej sasisë së përgjithshme të mbeturinave komunale të gjeneruara nga amvisëritë, dhe po ashtu nga aktivitetet ekonomike dhe industriale, një sasi të madhe e përbejnë edhe thasët dhe qeset e plastikës.

Prej të dhënave të marra nga Dogana e Kosovës, sasia e thasëve dhe qeseve të plastikës të importuara në vitin 2023 është 820,099 kg, ka shënuar një rënie prej 14% krahasuar me vitin 2022. Në anën tjetër, në vitin 2023 janë eksportuar 3,200,686 kg të thasëve dhe qeseve të plastikës, duke shënuar kështu një rritje prej 30% krahasuar me vitin 2022, kur eksporti ishte në 2,233,872 kg (figurat. 23 dhe 24).

Vlen të theksohet se në muajin gusht 2023 ka hyrë në fuqi *UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 07/2023 PËR AMBALAZHIN DHE MBETURINAT E AMBALAZHIT*, ku si derivat i këtij udhëzimi administrativ është edhe vendimi i MMPHI i datës 5 tetor 2023 për vendosjen e tarifës prej 5 cent për një qese të përdorur.

Përmes këtij vendimi synohet që të ndikohet në uljen e përdorimit të qeseve të një përdorshme dhe po ashtu edhe në ngritjen e vetëdijes qytetare për minimizimin gradual të përdorimit të këtyre qeseve, të cilat siç e cekëm më lartë, janë një burim i madh i ndotjes së mjedisit.




Figura 23: Sasia e thasëve dhe qeseve të plastikës së importuar, 2018-2023




Figura 24: Sasia e thasëve dhe qeseve të plastikës të eksportuara, 2017-2022

Në tabelat në vazhdim janë pasqyruar edhe sasitë dhe vlerat monetare të disa kategorive të mbetjeve të cilat janë importuar, respektivisht eksportuar gjatë vitit 2023. Këto të dhëna janë siguruar nga Dogana e Kosovës

Tabela 24: *Importi i mbetjeve gjatë vitit 2023*

Përshkrimi i mbetjeve të importuara në 2023	**kg**	**Vlera €**
Copa të vogla, ashkla, feta, mbetje bluarje, pluhur sharrimi dhe pluhur lëmimi	69,963.79	14,733.27
Të tjera mbetje dhe kthime te tjera ferrike	4,489.01	974.21
Total	**74,452.80**	**15,707.48**

Tabela 25: Eksporti i mbetjeve gjatë vitit 2023

Përshkrimi i mbetjeve të eksportuara në 2023	**kg**	**€**
Mbetje dhe kthime prej letrës apo kartonit të trashë të pazbardhur apo prej letrës apo kartonit të brimuar	8,851,230.00	1,348,199.30
Mbetje te tjera prej letrës apo kartonit të bërë kryesisht prej brumit mekanik	15,655,920.00	1,975,661.01
Mbetje te tjera prej letrës apo kartonit, të paseleksionuar	481,240.00	60,199.40
Të tjera mbetje dhe kthime te tjera ferrike	90,844,953.45	29,306,389.95
Total	**115,833,343.45**	**32,690,449.66**

3.5. Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit

3.5.1. Zonat e mbrojtura

Në kronologjinë e shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës mund të veçohen katër periudha kohore të cilat lidhen me zhvillimet e përgjithshme në Kosovë. Pas luftës së vitit 1999 janë shënuar rezultate të konsiderueshme në rritjen e numrit të përgjithshëm të zonave të mbrojtura si dhe në zgjerimin e sipërfaqeve të mbrojtura të natyrës të të gjitha kategorive.

Periudha 1950 - 1970, paraqet fazën fillestare të mbrojtjes së natyrës dhe shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë e cila fillon me shpalljen e zonës së parë në vitin 1950 që ishte "Gazimestani". Deri në fillimin e viteve të 70-ta, numri i zonave të mbrojtura kishte arritur në 19 (nëntëmbdhjetë). Në këtë periudhë janë vënë nën mbrojtje: Shpella e Gadimes dhe disa monumente të tjera me rëndësi botanike si: Rrapi në Marash, Trungjet në Isniq, etj.

Periudha në mes viteve 1970-1988, karakterizohet me shpalljen e numrit të konsiderueshëm të zonave të mbrojtura. Arsyeja e këtij suksesi është e lidhur me themelimin e Entit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në vitin 1974, nga Kuvendi i Kosovës. Në këtë periudhë, janë vënë nën mbrojtje gjithsej 32 zona, prej të cilave duhet veçuar: "Bifurkacioni i Lumit Nerodime", Parku i parë Kombëtar "Mali Sharr"(1986), Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën dhe Ujëvarën në Radavc (1983) si dhe disa monumente të tjera të natyrës.

Periudha 1989-1999, sikur në sferat tjera edhe në atë të mbrojtjes së natyrës kishte stagnim të plotë sa i përket shpalljës së zonave të mbrojtura. Ishte periudha kur si pasojë e përjashtimit të ekspertëve shqiptar nga institucionet për mbrojtjen e natyrës por jo vetëm, nuk kemi as edhe një zonë të mbrojtur ose të propozuar për mbrojtje.

Periudha pas vitit 2000 karakterizon rithemelimin e institucioneve të Kosovës, duke përfshirë Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, respektivisht Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Gjatë kësaj periudhe janë marrë nën mbrojtje ligjore rreth 200 zona të ndryshme dhe janë propozuar për mbrojtje mbi 30 zona tjera. Në mesin e zonave të mbrojtura duhet veçuar: Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"(2013), PK "Sharri" (i zgjeruar), Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës, Ligatina e Hencit - Radevës etj. Ndërsa shumicën zonave e përbëjnë monumentet e natyrës me karakter botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik etj.




Figura 25: *Numri i zonave të mbrojtura të natyrës 1950 - 2023*

Zonat e mbrojtura të natyrës – gjendja 2023- Numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë (2023) është 260 të cilat përfshijnë sipërfaqe prej 126,112.2 ha, ose 11.5 % e sipërfaqes të Kosovës. Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 19 Rezervate Strikte të Natyrës ("Rezervati i Arnenit", "Maja e Ropsit", "Rusenica", "Kamilja", etj.), 2 Parqe Kombëtare (PK "Sharri", PK "Bjeshkët e Nemuna"), 230 Monumente të Natyrës ("Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit", "Shpella e Gadimës", "Ujvarat e Mirushës", "Gryka e Rugovës", "Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshajtë", "Trungu i Rrapit në Marash" etj.), 1 Park i Natyrës ("Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës"), 7 Peizazhe të Mbrojtura ("Shkugëza" "Germia" dhe "Pishat e Deçanit"etj.) dhe një(1) Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve ("Ligatina e Hencit-Radeves"). Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e përbëjnë Parqet Kombëtare: "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Sharri", Parku i Natyrës "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës", Peizazhi i Mbrojtur "Germia", MNRV "Ujëvarat e Mirushës" dhe MN "Lokaliteti i Boshtres në zonën e Goleshit" etj.

Tabela 26: Numri dhe sipërfaqja e Zonave të Mbrojtura 2023

Kat. e IUCN-së	Emërtimi	Nr.	*Sipërfaqja/ha*	*Pjesë. ne siper. e pergjith. te ZM*
I	Rezervatet Strikte të Natyrës	19	10,882.96	7.7
II	Parqet Kombëtar	2	115,957	82.1
III	Monumentet Natyror	230	6,180.90	4.4
V	Park Natyre	1	5,934	4.2

V	Peizazh i Mbrojtur	7	2,319.85	1.6
V	Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve	1	109.5	0.08
	Totali	260	126122.75[16]	100[17]

Gjatë vitit 2023 nën mbrojtje ligjore janë vënë 3 monumente të natyrës në komunën e Suharekës: Trungu i Qarrit (*Quercus sp*) në Suharekë, Trungu i dushkut (*Quercus sp*) në Krushicë të Poshtme dhe Trungu i dushkut (*Quercus sp*) në Bllacë, ndërsa në procedurë për vënie nën mbrojtje janë edhe mbi 30 monumente të natyrës në komunat: Pejë, Prizren, Kamenicë dhe Artanë.

3.5.2. Biodiversiteti

Zonat e rëndësishme të biodiversitetit janë: "Malet e Sharrit", "Bjeshkët e Nemuna", Shala e Bajgores", "Kopaoniku", "Kortiniku", "Pashtriku", "Kozniku", "Blinaja", "Gërmia" etj, të cilat karakterizohen me prezencën e faunës. Këto zona janë të pasura edhe me lloje të bimëve të rralla dhe endemike të cilat radhiten në dy grupe: endemik lokal apo stenoendemik dhe endemik të Ballkanit.

Llojet bimore endemike lokale apo stenoendemike[18]

1. Barpezmi i Aleksandrit *(Achillea alexandri-regis)*
2. Bornmylera e Dickit *(Bornmullera dieckii)*
3. Cerasiti i Sharrit *(Cerastium neoscardicum)*

Taksonet e reja të florës vaskulare[19]

Krokusi i verdhë *(Crocus flavus)*, Rrënja *(Quercus robur subsp. Pedunculifora),* Lule misër *(Cyanus lingulatus)*, Dëllinja savine **(***Juniperus sabina),* Zhabina e degenit *(Ranunculus degenii)*, Manushaqja dukë *(Viola herzogii)*, Pulsatila alpine *(Pulsatilla alpina),* Minuarta umbrellore **(***Minuarta baldaccii* subsp. *Baldacii), Gjipsofila me gjethe spergule* **(***Gypsophilia supergulifolia).*

Flora dhe vegjetacioni

Numri i taksoneve të përfshira në Librin e Kuq të Florës Vaskulare (sipas Raunkierit) tregon se dominojnë Hemikriptofitet me 155 taksone, Gjeofitet me 32 dhe Kamefitet me 27, Fanerofitet me 19 taksone dhe Terofitet me 4 taksone.[20]

[16] Sqarim: kjo sipërfaqe e zonave te mbrojtura nuk përfshinë zonat e mbrojtura që gjenden në kuadër të Parqeve Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna"

[17] Sqarim: perqindja është nxjerr nga siperfaqja e pergjithshme duke perfshirë edhe siperfaqen e zonave të mbrojtura brenda parqeve kombëtare.

[18] Flora dhe Vegjetacioni i Kosovës, Rexhepi F. (1982)

[19] Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës, Fadil M, Ferat R, Elez K, Qazim P, Xhavit M, Naim B, (2013)

[20] Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës, Fadil M, Ferat R, Elez K, Qazim P, Xhavit M, Naim B, (2013)

Statuti i llojeve të vlerësuara- në Librin e Kuq të Florës Vaskulare janë punuar gjithsejtë 237 taksone, nga të cilat në bazë të kritereve të IUCN-së (bazuar në "Udhëzuesin për Shfrytëzimin e Kategorive dhe Kritereve të Listës së Kuqe të IUCN'së" Versioni 8.1 (gusht 2010) janë vlerësuar dhe kategorizuar si vijon: I Zhdukur (EX) 1 lloj apo 0.4 %, I zhdukur si gjendje spontane ose të egër (EË) 1 lloj apo 0.4 %, I rrezikuar në mënyrë Kritike (CR) 61 taksone apo 26 %, I Rrezikuar (EN) 86 taksone apo 36 %, I Përkeqësuar (VU) 19 taksone apo 8 %, Gati i Rrezikuar (NT) 34 taksone apo 18 % dhe Më pak i Rrezikuar (LC) 35 taksone apo 16 %.

Vegjetacioni - Vegjetacioni i Kosovës klasifikohet në: 139 asociacione apo fitocenoza, 63 aleanca, 35 rende dhe 20 klasa, të cilat paraqesin ekosisteme karakteristike, të cilat janë gjithashtu habitate për shumë lloje të shtazëve. Vegjetacioni i livadheve të ultësirave klasifikohet në: 4 asociacione që i përkasin një aleance, një rendi dhe një klase. Ndërsa vegjetacioni i livadheve kodrinore subalpike dhe alpike klasifikohet në: 65 asociacione, 33 aleanca, 22 rende dhe 13 klasa.

Fauna - Vendi ynë është i pasur dhe mjaft heterogj sa i përket faunës. Kjo pasuri faunistike është si rezultat i ndikimeve të shumta të regjionit mesdhetar, euro-siberian dhe atij nordiko-alpin, si dhe i ndryshimeve të shpeshta të kushteve ekologjike nga e kaluara. Në vendin tonë mund të gjenden lloje të gjitarëve dhe shpendëve etj, që janë mjaft të rralla jo vetëm për rajonin e Ballkanit por edhe më gjërë.

Disa lloje janë relikte dhe të kërcënuara nga zhdukja dhe për këtë arsye gjenden në listat e konventave ndërkombëtare. Në bazë të hulumtimeve të gjertanishme dhe shënimeve të literaturës janë prezente shumë lloje të egra të kurrizorëve, prej të cilave mund të përmendim: peshqit, ujëtokësorët, rrëshqitësit, shpezët dhe gjitarët. Pyjet e larta dhe ekosistemet malore ofrojnë kushte të volitshme për jetesën e popullatave të gjitarëve të mëdhenj si: Ariu i murrëm (*Ursus arctos*), Rrëqebulli (*Lynx lynx*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), pastaj të shumë llojeve të shpendëve grabitqare dhe këngëtare, mjaft të rëndësishme për ornitofaunën e Kosovës, Ballkanit dhe Europës. Shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), Fajkoi thonjëbardhë (*Falco naummani*), Pulegra (*Tetrao urogallus*) janë disa nga llojet më reprezentative të vendit, e të cilat kanë edhe status ndërkombëtar të mbrojtjes. Ato gjenden në listën e IUCN-së (Unioni Botëror për Ruajtjen e Natyrës), EU-RL (Lista e Kuqe Evropiane), wR-RL (Lista e Kuqe Botërore).

Fauna përfaqësohet gati me të gjitha llojet që jetojnë në Gadishullin Ballkanik. Grupi më i përfaqësuar i gjitarëve për nga numri i llojeve janë brejtësit. Klasën e gjitarëve e përbëjnë insektengrënësit: Iriqi (*Erinaceus europeus*), Urithi (*Talpa europae*), Rrëmihësi i rëndomtë (*Sorex araneus*) dhe brejtësit, Lepuri i fushës *(Lepus europaeus*), *M*iu bizam (*Ondatra zibethica*), Miu i fushës (*Arvicola terrestris*), Miu i shtëpisë (*Mus musculus*),

Miu me vija *(Apodemus agrarius*), Miu i pyllit (*Apodemus silvaticus*) Gjeri i madh (*Glis glis*) etj.

Kurse prej mishngrënësve janë: Rrëqebulli *(Lynx lynx*), Ariu i murrëm (*Ursus arctos*), Ujku (*Canis lupus),* Dhelpra *(Canis vulpes*), Macja e egër *(Felis silvestris*) etj. Në grupin e jopërtypësve është: Derri i egër *(Sus scrofa*). Kurse ripërtypës janë: Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra)* etj. Lakuriqët (*Chiroptera*) janë shumë pak të studiuar.

Në vendet ku janë vendosur kamerat janë fotografuar dhe regjistruar llojet e ndryshme të gjitarëve. Të dhënat për praninë e llojeve të faunës së egër reflektojnë gjendjen faktike në hulumtimet e diversitetit shtazor. Mirëpo, akoma ka mungesa thelbësore sa i përket të dhënave rreth popullatave për një numër të madh të llojeve shtazore, numrit të individëve, trendit të tyre dhe faktorëve që i kërcënojnë ato.

3.5.3. Gjendja e resurseve pyjore

Kosova karakterizohet me një sipërfaqe të qëndrueshme pyjore me rreth 481,000 ha. Kosova ka të mbuluar me pyje 45% të sipërfaqes, që konsiderohet një potencial i qëndrueshëm për zhvillim të vendit, nga të cilat rreth 62% janë pyje publike ndërsa rreth 38% konsiderohen si pyje private.

Bazuar në inventarin e pyjeve, zonat e mbrojtura apo pyjet shtrihen në rreth 12% të sipërfaqes të përgjithshme të tyre dhe në vete ngërthejnë rreth 36% të volumit të përgjithshëm.

Ndikimi apo impakti për qasje ekonomike është i madh, bazuar në të dhënat e mësipërme, por edhe në faktin se pyjet me vlera më të mëdha ekonomike (pyjet e larta trungishtet) gjenden brenda dy parqeve kombëtare: "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna".

Figura 26 prezanton shpërndarjen e sipërfaqeve, ku shihet se përqindja më e madhe i takon pyjeve, tokës bujqësore, livadheve/kullosave dhe kategori tjera.




Figura 26: *Klasat e përdorimit të tokës në Kosovë*

Pyjet e Kosovës janë të dominuara nga pyjet fletore, duke mbuluar 93% (449,400 ha) të sipërfaqeve pyjore, ku më shumë se gjysma janë një-moshare, ndërsa 5% (23,800 ha) e sipërfaqeve pyjore mbulohet nga pyjet halore të cilat janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në mes të klasave të ndryshme të strukturës. Plantacionet e pishave kontribuojnë në sipërfaqet një-moshare. Në total, 50% e sipërfaqes pyjore është konsideruar një-moshare.

Tabela 27: Sipërfaqja pyjore sipas përbërjes dhe strukturës së grumbullit (ha)

Përbërja pyjore	Regjistrimi	Një-moshar	Dy-katësh	Shumë moshar	Totali
Halore	2,200	6,400	6,200	8,800	23,800
Përzier	0	400	3,200	4,200	7,800
Fletore/gjethore	45,400	236,000	123,600	44,400	449,400
Totali	**47,600**	**243,000**	**133,000**	**57,400**	**481,000**

Realizimi i shfrytëzimit të pyjeve shtetërore në vitin 2023, sipas Drejtorive Koordinuese ka qenë i planifikuar gjithsej:

- Shfrytëzim i ngastrave pyjore nëpërmjet tenderimit 52,821.38 m³.
- Shfrytëzim i ngastrave pyjore, furnizim me dru djegie për ekonomi familjare 26,666.68 m³.
- Planifikim i masës drunore nga rrallimet paratregtare 5,419.75 m³.

Nga kjo rrjedh se shfrytëzimi i pyjeve ne ngastrat me pronësi shoqërore 84,908.49 m³. shfrytëzimi i pyjeve ne ngastrat me pronësi private 192,000.00 m³. Gjithsej ne dy sektorët ka vëllim prej **276,908.49 m³.**

Tabela 28: Prerjet ne pyjet me pronësi private dhe shoqërore për vitin 2023

Pronësia	**Pyje shtetërore (m³)**	**Pyje private (m³)**
Nën total	84,908.49 m³.	192,000.00 m³
Total	**145,705.65**	

Në fidanishten e Institutit të Pejës janë kultivuar gjithsej 857,500 fidan pyjor, nga këto 450,000 copë janë halor klasik dhe 407,500 janë fletor klasik.

4. Ndikimet mjedisore në shëndetin publik

Hulumtimet e shumta shkencore dhe nga praktika e kujdesit shëndetësor është gjetur se efekti i ndotjes së mjedisit ndikon në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore si dhe rrit vdekshmërinë e parakohshme të njerëzve. Indikatorët ndotës më theks të veçantë si grimcat e pluhurit PM10 dhe PM2.5, ndërlidhjen me ndikimin më të madh në shëndet për shkak të aftësisë së grimcave që depërtojnë thellë në mushkri duke krijuar probleme zinxhirore shëndetësore në njerëz. Numri i rasteve të sëmundjeve në Kosovë të ndërlidhura direkt apo indirekt me ndotjen e mjedisit ka një ulje të trendit përkundër vitit paraprak. Nga të dhënat e IKSHPK në periudhën janar – dhjetor 2023, janë raportuar gjithsej 245,754 raste të sëmundjeve ngjitëse me Mb 13,790.02/100.000 banorë. Ky numër i sëmundjeve ngjitëse është dukshëm më i ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, me 331,545 raste të raportuara ose Mb 18,604.02/100,000 banorë. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, janë raportuar 191 raste të vdekjeve nga sëmundjet ngjitëse. Në këtë ulje të numrit të rasteve dhe vdekjeve të raportuar pa dyshim ka ndikuar numri më i vogël i raportuar me COVID-19 te paraqitura në tabelën 29.

Tabela 29: Numri i rasteve dhe incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në periudhën janar- dhjetor të vitit 2022 dhe 2023

Sëmundjet	Janar-Dhjetor, 2022		Janar-Dhjetor, 2023	
	Nr.	Incidenca/100.000	Nr.	Incidenca/100.000
COVID-19	110755	6214.81	2153	120.81
ITPR - Pneumonia/ARI	16179	907.85	16950	951.12
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	280	15.71	262	14.70
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	100478	5638.13	129315	7256.27
Influenca A	58	3.25	235	13.19
Influenca AH1N1			47	2.64
Influenca A H3			1	0.06
Influenca B			179	10.04
Influenca B/Victoria			29	1.63
RSV	68	3.82	68	3.82
Human Adenovirus			4	0.22
Diarea akute	91247	5120.15	82884	4650.88
Variçela	10972	615.67	10999	617.19
Sindromi meningjeal	112	6.28	232	13.02
EHSV	1	0.06	2	0.11
Kampilobakter	1	0.06	1	0.06
Helmimet me ushqim	504	28.28	936	52.52
Salmonella enteritidis	31	1.74	76	4.26
Shigelloza	1	0.06	2	0.11
Clostridium difficile			2	0.11
E.coli (O 157)	1			0.00
E coli patogjene			2	0.11
Rotavirus	162	9.09	73	4.10
Gastroenterokolitet	253	14.20	398	22.33
Adenovirus	32	1.80		0.00
Hepatiti akut A	23	1.29	3	0.17
Hepatiti akut B	25	1.40	37	2.08
Hepatiti akut c	4	0.22	4	0.22
Ethe tifoide		0.00		0.00

Morbilli	1	0.06	1	0.06
Parotiti epidemik	25	1.40	30	1.68
Pertussis	1	0.06	2	0.11
TBC		0.00		0.00
Tularemia	2	0.11	4	0.22
Brucellosis	22	1.23	33	1.85
Leptospirosis	8	0.45	5	0.28
Toxoplasmosis	3	0.17	8	0.45
Malarie**	1	0.06	3	0.17
Echinoccocosis		0.00	2	0.11
Leishmaniaze	1	0.06	7	0.39
Sëmundja Lyme	16	0.90	12	0.67
Ëest Nile Virus			1	0.06
HIV/AIDS	21	1.18	20	1.12
IST	178	9.99	480	26.93
Parazitozat	16	0.90	20	1.12
Giardiaza		0.00	46	2.58
Askariaza			7	0.39
Entameba Hystolitica		0.00	1	0.06
*Sëmundjet tjera ngjitëse	63	3.54	178	9.99
Gjithsej	**331545**	**18604.02**	**245754**	**13790.02**
*Sëmundjet tjera ngjitëse: Scariatina, Herpes zoster, Erysipella, Mykozat, Mononucieoza				
**Malarie Importuar				

Numri i sëmundjeve të paraqitura në raportin e Buletinit Vjetor 2023 në Kosovë vërehet më i ulët krahasuar me periudhën e njëjte të vitit 2022. Numër më i lartë i rasteve të raportuara shihet te sëmundjet e formës së agreguar si: Pneumonitë, Influenca sezonale, Diaretë akute dhe Variçella. Zoonozat (brucelloza humane, tularemia, toxoplazmoza): krahasuar me vitin 2022 vërehet tendencë në rritje të numrit të rasteve të raportura veçanërsht me Brucellozë.Sëmundjet transmisive si: Leishmania dhe Malaria raportohen me numër më të lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 si dhe ËNV me një rast. Gjithashtu edhe sëmundjet që përhapen me ujë dhe ushqim si helmimet me ushqim, raportohen në numër më të lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ndërsa Hepatiti A, Rota dhe Aenovirozat raportohen në numër më të ulët. Sëmundjet vaksinëpreventabile (Parotiti epidemik, Pertussis), raportohen në numër më të lartë krahasuar me periudhën paraprake. Rastet me IST këtë vit tregojnë rritje të numrit të rasteve të raportuara përderisa HIV/AIDS raportohet përafërsisht me numër të njëjtë si gjatë vitit 2022.

5. Gjendja e mjediseve të rrezikuara

5.1. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të KEK-ut

Republika e Kosovës është në mënyrë të plotë e varur nga linjiti si burim kryesor për prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjen e shtëpive dhe bizneseve. Megjithëse Republika e Kosovës ka potencial për burime të tjera të energjisë, siç janë hidroenergjia, energjia e erës dhe fotovoltaike. Qasja në energji të ripërtrishme në prodhimin total të energjisë është ende e kufizuar. Ata shihen si burime të shtesës për të plotësuar kërkesën për energji elektrike në vend.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) nuk ka respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor gjatë vitit 2023. Kjo mungesë e respektimit të standardeve mjedisore është shqetësuese dhe paraqet një sfidë për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë. Mungesa e monitorimi të ndikimeve mjedisore në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) përfshin aspekte të rëndësishme të mjedisit si uji, ajri, toka, zhurma, vibracionet, bimësia, fauna dhe mbeturinat (vajrat). Kjo situatë shkakton shqetësim në lidhje me mbrojtjen e mjedisit në KEK dhe në vend. Është e rëndësishme që procedurat e përzgjedhjes së operatorit të monitorimit të mjedisit të realizohen në afat të arsyeshëm dhe që monitorimi i ndikimeve mjedisore të ketë një rol të rëndësishëm në politikat dhe veprimet e KEK-ut për të mbrojtur dhe ruajtur mjedisin. Disa tregues kryesor të operimit të KEK janë prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela 30: Disa nga treguesit kryesor të operimit të KEK-ut gjatë vitit 2023

Treguesit	**2023**
Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga `TC Kosova A`	2290512 (MËh)
Prodhimi i energjisë elektrike nga `TC Kosova B`	3243685 (MËh)
Harxhimi i përgjithshëm i linjitit	7,437,452 (t)
Sasia e përgjithshme e hirit të prodhuar	1086754 (t)
Konsumi i ujit të dekarbonizuar dhe të demineralizuar `TCA` dhe `TCB`	19.373.762 (m3)

Mbeturinat e gjeneruara në KEK, përveç hirit si mbetje pas djegies së qymyrit në procesin teknologjik, janë edhe forma tjera të mbeturinave të gjeneruar të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 31: Mbeturinat metalike, vajra, shirit transportues

TC	**Mbeturina të hekurit (kg)**	**Mbeturina të bakrit (kg)**	**Vajra (lit.)**	**Shirit transportues. (kg)**
TC A	400 000	2 500	**0**	7 000
TC B	161 000	4 000	10,288.00	0
Total	**561 000**	**6 500**	**10,288.00**	**7 000**

Mbeturinat me përmbajtje Azbesti - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) është detyruar të ndërmarrë të gjitha masat sipas dispozitave të veçanta ligjore për të siguruar që aktiviteti i tij, përfshirë shfrytëzimin e produkteve që përmbajnë azbest gjatë veprimtarive të ndryshme, të mos shkaktojnë ndotje të mjedisit me fibra.
Edhe pse është kryer inventarizimi i materialeve që përmbajnë azbest, KEK është aktualisht në proces të përgatitjes së hapësirave deponuese për këtë material. Është e rëndësishme që kjo përgatitje të kryhet në përputhje të plotë me ligjin dhe standardet mjedisore për të siguruar që depozitimi i materialeve që përmbajnë azbest të bëhet në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme për të shmangur ndotjen e mjedisit me fibra azbesti.
Në tabelën 32 janë prezantuar emisionet vjetore në ajër për ndotësit SO_2, NOx dhe pluhurin total në të dy Termocentralet e `Kosova A` dhe `B`.

Tabela 32: Emisionet vjetore në ajër për ndotësit SO2, NOx dhe pluhurin total nga `TCA` dhe `TCB` 2022-2023

TC	SO2 (t/vit)		NOx (t/vit)		Pluhuri total (t/vit)	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023
TC A3	1823	1710.4	2318	2280.59	2271	225.19
TC A4	2610	2236.6	3060	615.41	2713	269.20
TC A5	1185	1491	1491	600.96	1380	195.0
TC B1	4329	2209	5347	4090.1	2606	2135.8
TC B2	3344	2848	4347	3797.64	2158	1917.8
Totali	13292 (t/vit)	10,495(t/vit)	16564(t/vit)	11,384.7(t/vit)	5401(t/vit)	4,742.99 (t/vit)

Termocentralet "Kosova A": Për ndotësin SO2, emetimi ka rënë në të gjitha njësitë (TC A3, TC A4, TC A5) nga viti 2022 në vitin 2023. Kjo tregon një përmirësim në performancën përmbajtëse në këto termocentrale. Për ndotësin NOx, ka një rritje në emetime në TC A3 dhe TC A4, ndërsa një rënie në TC A5 nga viti 2022 në vitin 2023. Pluhuri total ka rënë në të gjitha njësitë përveç TC A5.

Termocentralet "Kosova B": Për ndotësin SO2, emetimi ka rënë në të dy njësitë (TC B1 dhe TC B2) nga viti 2022 në vitin 2023. Për ndotësin NOx, ka një zbritje në emetime në të dy njësitë. Pluhuri total gjithë ashtu i ka rënë emitimi në të dy njësitë. Përgjithësisht, në të dy termocentralet, ka një trend në rënie të emetimeve ndotëse në ajër. Është e rëndësishme të vazhdohet monitorimi dhe implementimi i masave për të zvogëluar emetimet e ndotësve për të përmbushur standardet mjedisore dhe për të mbrojtur cilësinë e ajrit.

5.2. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të Feronikelit

Fabrika e Feronikelit ka qenë në prodhim gjatë periudhës qershor – tetor 2023 (në tërësi 5 muaj prodhim gjatë vitit 2023). Monitorimi i mjedisit për sa kohë ka qenë e mundur të realizohet gjatë vitit 2023 përfshin monitormin e parametrave të rëndësishëm mjedisore, siç janë ajri, uji dhe toka, si dhe ndërhyrje të nevojshme për të minimizuar ndikimin në mjedis. Me që për prodhimin e produktit final, ferronikelit i nevojitet një konsum i madh i energjisë elektrike dhe e cila ka një çmim relativisht të lartë, së bashku me rritjen e lëndëve të para dhe lëndëve ndihmëse për procesin e prodhimit, po e bëjnë operimin të vështirë për kompaninë pasi kostoja e prodhimit është e lartë në krahasim me çmimin e shitjes së nikelit në treg. Si rezultat, kompania nuk ka mundur të operoj normalisht gjatë vitit 2023.

Disa nga matjet që ishin planifikuar për të matur cilësinë e ajrit në deponinë e skories dhe në minierën e Gllavicës nuk janë realizuar sipas planit për shkak të ndalesës së detyrueshme të prodhimit, shembull cilësia e ajrit në deponinë e skories është realizuar vetëm një herë nga dy sipas planit. Ndërsa në minierën e Gllavicës është realizuar një herë nga dy sipas planit.

Monitorimi i pluhurit të depozituar (Aerosendimenti) gjatë vitit 2023 është bërë në 9 pika monitoruese, 6 brenda fabrikës dhe 3 jashtë fabrikës. Nga rezultatet e paraqitura përgjatë periudhës qershor-tetor sa ka operuar kompania vërehet se nuk ka tejkalime bazuar në standardin për aerosendiment (sipas OBSH-së) 300 mg/m²/ditë (figura 27).




Figura 27: *Paraqitja e vlerës mesatare për aerosediment për muajt: qershor – tetor 2023 (sa është punuar)*

Furrat Rrotulluese: shkarkimi i pluhurit dhe gazrave nga furrat rrotulluese është nën Vlerën Kufizuese të Emetimeve (VKE). Kjo do të thotë që operacionet e tyre janë në përputhje me standardet e përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit.

Furrat Elektrike: Furrat elektrike janë të pajisura me sisteme pastrimi të dizajnuara për të përmbushur kriteret mjedisore, me efikase dhe të modernizuara. Është e rëndësishme të përmendet se kanë punuar vetëm me furrën elektrike FE1, sepse FE2 nuk ka qenë në operim gjatë vitit 2023. Kjo mund të ketë ndikuar në kapacitetin e prodhimit të fabrikës dhe në ndjeshmërinë e procesit në tërësi.

Konvertorët: gjendja me shkarkimin e pluhurit dhe gazrave nga konvertorët është në nivel të kënaqshëm dhe nuk ka pasur tejkalime të VKE. Kjo mund të jetë për shkak se konvertori punon me cikle (faza) dhe nuk ka lirim kontinual të pluhurit dhe gazrave.

Në tabelën 33 është paraqitur sasia totale emisioneve të pluhurit të emetuara në ajër për vitet 2022 dhe 2023, të shprehura në ton. Sasia totale e pluhurit të emetuar gjatë vitit 2023 ishte rreth 48.45 ton, ndërsa gjatë vitit 2022 rreth 11.51 ton. Shkarkimi më i madh është matur tek furra elektrike.

Tabela 33: Përmbledhje e rezultateve vjetore të matura te pluhurit të emetuar nga Feronikeli për vitin 2023

Viti	Pluhuri Furra elektrike mg/Nm3	Pluhuri Konvertori mg/Nm3	Pluhuri Furra rrotulluese mg/Nm3	Totali i pluhurit mg/Nm3
2022	0.09	1.67	9.75	11.51
2023	17.87	13.18	17.4	48.45

Kjo tabelë tregon rritjen të sasisë totale të pluhurit të emetuara nga viti 2022 në vitin 2023. Në vitin 2023, të gjitha njësitë (Furra Elektrike, Konvertori, dhe Furra Rrotulluese) kanë shfaqur një rritje të konsiderueshme në sasitë e pluhurit të emetuara krahasuar me vitin 2022.

Kjo rritje mund të jetë e shkaktuar nga faktor të ndryshëm si rritja e prodhimit, mungesa e përdorimit të teknologjive të pastrimit të pluhurit, apo probleme të tjera teknike në proceset e prodhimit. Është e rëndësishme që të kryhet një analizë e thellë për të identifikuar shkakun e kësaj rritjeje dhe për të ndërmarrë masat e duhura për të zvogëluar emetimet e pluhurit dhe për të mbrojtur mjedisin.

Në tabelën 34 janë paraqitur të dhënat për sasinë totale të emisioneve të CO, NOx dhe SO_2, të shkarkuar në ajër për vitet 2022 dhe 2023, të shprehura në mg/Nm3.

Tabela 34: Sasia totale vjetore e ndotësve CO, NOx dhe SO_2 për vitin 2023 nga Feronikeli

Gazrat	Konvertori A2.2		Furra rrotulluese A2.1		Totali	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023
CO mg/Nm3	/	669.5	/	684.60	/	1,354.1
NOx mg/Nm3	7,38	229.73	10.53	384.62	17.91	614.35
SO_2 mg/Nm3	3,24	354.74	36,53	341.76	39.77	696.5

Monoksidi i Karbonit (CO) (mg/Nm3): nuk ka të dhëna për vitin 2022 për CO, në vitin 2023 Konvertori A2.2 shfaq një emetim prej 669.5 mg/Nm3.

Oksidet e Azotit (NOx) (mg/Nm3): në vitin 2022, NOx është raportuar në nivelin e 7.38 mg/Nm3 për Konvertorin A2.2 dhe 10.53 mg/Nm3 për Furra Rrotulluese A2.1. Në vitin 2023, NOx ka përjetuar një rritje ndjeshme në të dy njësitë, duke arritur vlerat e 229.73 mg/Nm3 për Konvertorin A2.2 dhe 384.62 mg/Nm3 për Furra Rrotulluese A2.1.
Dioksidi i Sulfurit (SO2) (mg/Nm3): në vitin 2022, SO2 është raportuar në nivelin e 3.24 mg/Nm3 për Konvertorin A2.2 dhe 36.53 mg/Nm3 për Furra Rrotulluese A2.1, në vitin 2023, emetimi i SO2 ka rënë në të dy njësitë, duke arritur vlerat e 354.74 mg/Nm3 për Konvertorin A2.2 dhe 341.76 mg/Nm3 për Furra Rrotulluese A2.1.

Gazrat e monitoruara (CO, NOx, SO2) tregojnë një rritje të ndjeshme të emetuara në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

Cilësia e ujërave – Operimi pjesërisht gjatë vitit 2023 mund të ketë ndikuar në të dhënat dhe rezultatet e raporteve mjedisore, duke reflektuar një aktivitet të reduktuar ose të kufizuar në krahasim me një vit operacional të plotë. Nga rezultatet vjetore të parametrave të matura në ujin sipërfaqësor dhe nëntokësor, nëse këto vlera krahasohen me vlerat e lejuara sipas Udhëzimit Administrativ (*UA/MMPHI 02/2022 për vlerat kufizuese të lejuara për shkarkimet në ujërat sipërfaqësor dhe ne trup ujor)*, vërehet se nuk ka tejkalime të vlerave të lejuara për parametrat e matura. Në ujërat nëntokësor, gjithashtu, parametrat e matur janë nën vlerat limite, po ashtu, edhe metalet e rënda për ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor nuk i tejkalojnë vlerat e lejuara, sipas të dhënave të prezantuara në raportet mujore dhe në raportin vjetor. Këto rezultate pozitive tregojnë për një përmbushje të mirë të standardeve të përcaktuara për kualitetin e ujit.

Menaxhimi i mbeturinave gjatë vitit 2023 ka përfshirë një sasi të konsiderueshme të mbeturinave industriale, veçanërisht skorien e cila është deponuar në deponinë e skories Dushkaja 1, në zonën e minierës së Çikatovës. Sasia e mbeturinave të skories që është deponuar ka qenë 230,042 ton, krahasuar me vitin 2022, kur sasia ishte 46,195 ton.

Kjo diferencë shfaq një rritje të konsiderueshme në prodhimin dhe gjenerimin e mbeturinave gjatë vitit 2023. Është e rëndësishme të theksohet se skoria e konvertorit është ricikluar në proces, duke treguar një përpjekje për të minimizuar ndikimin e mbeturinave në mjedis dhe për të përdorur burimet në një mënyrë më të qëndrueshme.

Kjo situatë shënon nevojën për një përqendrim të vazhdueshëm në menaxhimin e mbeturinave. Forma për të gjetur metoda më të efektshme për të trajtuar dhe ricikluar mbeturinat e skories në mënyrë të përshtatshme për mjedisin, do të ishte me prioritet.

Në tabelën 35 janë paraqitë llojet e këtyre mbeturinave dhe sasia vjetore gjatë vitit 2023

Tabela 35: Gjenerimi i mbeturinave industriale nga Feronikeli për vitin 2023

Treguesit	2022	2023
Skoria e gjeneruar nga furra elektrike, të deponuarë në deponinë e skories `Dushkaja 1`.	46,195 t	230, 042t
Skorie e gjeneruar nga konvertori e deponuar brenda objektit	3316 t	16 179 t
Materialet zjarrduruese të përdorura	0 t	0 t
Llumi nga sistemet e pastrimit	1493 t	52 t

5.3. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të Sharrcem

Monitorimi i vazhdueshëm i emetimeve nga burimet kryesore ndihmon operatorin Sharrcem të identifikoj dhe të monitoroj nivelin e ndotjes së mjedisit nga veprimtaria e tyre. Kjo gjithashtu u jep autoriteteve kompetente dhe publikut një transparencë të rëndësishme në lidhje me ndikimin mjedisor të aktiviteteve të Sharrcemit.

Emetimet në ajër – Në vitin 2023, emisionet totale të NOx në Sharrcem ishin nën pragun e kufirit (VKE) të përcaktuara nga legjislacioni vendor dhe të kërkesave të IPPC. Kjo ka rezultuar në nevojën për sasi më të larta të lëndës djegëse, duke shkaktuar rritje në emetimin e NOx. Kjo situatë tregon një sfidë në menaxhimin e ndryshimeve në procesin prodhues të Sharrcemit për të siguruar përputhjen me standardet mjedisore. Është e rëndësishme që Sharrcem të ndërmarrë hapa të nevojshëm për të kuptuar dhe për të zvogëluar impaktin e rritjes së emetimeve të NOx, duke përdorur teknologjitë dhe praktikat më të mira të disponueshme për kontrollin e ndotjes së mjedisit. Kjo përfshin investime në teknologji të pastër dhe përdorimin e proceseve inovative për të zvogëluar ndikimin e emetimit të NOx në mjedis.
Bazuar në rezultatet e matjeve nga sistemi i monitorimit të vazhdueshëm është paraqitur një trend i përqendrimit mesatar vjetor të emetimeve të (SOx) dhe oksideve të azotit (NOx) nga furra rotulluese gjatë viteve të fundit (figura 38).




***Figura 28**: Trendi i emisioneve të NOx dhe SOx për vitet 2021-2023*

Nga rezultatet e monitorimit të cilësisë së ajrit në Hanin e Elezit, përmes sistemit të instaluar nga Ministria e Mjedisit dhe monitoruar nga Instituti Hidrometerologjik i Kosovës gjatë vitit kalendarik 2023, rezultojnë të dhëna për parametrat kryesor të

cilësisë së ajrit. Bazuar në këto të dhëna, vërehet se nuk ka pasur tejkalime të theksuara të parametrave të cilësisë së ajrit gjatë këtij viti.

Cilësia e ajrit në zonën e fabrikës – Nga vetëmonitorimi i cilësisë së ajrit në perimetrin e fabrikës dhe minierës, gjithashtu vërehet se nuk ka pasur tejkalime të parametrave kryesor të cilësisë së ajrit. Kjo tregon një përmbushje të kujdesshme të standardeve mjedisore dhe një angazhim të fortë për ruajtjen e cilësisë së ajrit në këtë zonë industriale.

Menaxhimi i ujërave - Sistemi i menaxhimit të ujit kanë lejuar për një monitorim më të mirë të përdorimit të ujit në mënyrë që të identifikohen dhe të zbatohen masa për përdorimin më të qëndrueshëm dhe të efikas të burimeve të ujit. Kjo siguron një qasje më të përgjegjshme ndaj përdorimit të burimeve të ujit dhe ndihmon në përmbushjen e synimeve të mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.

Shfrytëzimi i përgjithshëm i ujrave për prodhimin e çimentos, krahasuar me vitin 2022, në vitin 2023 ka qenë për 31,594 m^3 uji më pak. Kjo ulje e shfrytëzimit të ujrave për prodhimin e çimentos tregon një ndryshim në aktivitetin industrial midis dy periudhave.

Cilësia e ujërave të përdorura dhe të shkarkuara - Parametrat monitorues të shkarkimit të ujërave të trajtuar kanë qenë nën vlerat e lejuara kjo tregon që Sharrcem është në rrugën e duhur për të siguruar që shkarkimi i ujërave të trajtuar në mjedis është në përputhje me standardet mjedisore dhe që nuk ka ndikim negativ në burimet ujore dhe në ekosistemin e përgjithshëm. Shkarkimi total i ujërave krahasuar me vitin 2022, në vitin 2023 ka qenë 21.054 m3 uji më pak. Kjo ulje e shkarkimit total të ujërave tregon një ndryshim në volumin e ujërave të shkarkuara nga Sharrcem midis dy periudhave.

Menaxhimi i mbeturinave - Në vitin 2023 janë bërë investime të mëdha në menaxhimin e mbetjeve. Rikonstruktimi i hales së vjetër të klinkerit, duke e transformuar në një objekt për deponimin e bottom ash-it dhe piritit, është një investim me vlerë të të rendesie të veçant.Poashtu, objekti i ish-kazanave të avullit është renovuar për qëllime të deponimit të mbetjeve elektronike, tonereve, si dhe për deponimin e vajrave, duke kryer të gjitha ndërhyrjet e nevojshme për të siguruar një deponim të sigurt për to. Ndërhyrje të mëdha janë bërë edhe në zonën e mbetjeve, duke i ndarë ato në zona të veçanta në varësi të llojit të mbetjeve dhe duke i kategorizuar ato me tabela të veçanta.

Përdorimi i objekteve të rikonstruktura për qëllime të specifikuara të deponimit është një mënyrë e mire për të rritur efikasitetin dhe për të zvogëluar ndikimin e negativ të mbetjeve në mjedis. Kjo gjithashtu shënon një angazhim të Sharrcem në përmbushjen e synimeve të qëndrueshme dhe të përgjegjshme të mjedisit.

Tabela 36: Gjenerimi i mbeturinave sipas kategorive nga Sharcem për vitin 2023

Viti	Mbetje të përziera komunale (t/v)	Scrap (t/v)	Tulla për murim te furres (t/v)	Thasë të shkyer të cem. (t/v)	Letër dhe karton (t/v)	Mbetje nga demolimet (t/v)	Paleta të drurit (m3/v)	Vajra të përdorur (t/v)
2022	47.79	211.82	233.2	15.4	2.5	466.4	3.86	0.5
2023	59.8	211.8	274.0	22.7	2.7	506.8	30.8	0.3

Krahasuar me vitin 2022, Sharrcem gjatë vitit 2023 ka gjeneruar më shumë mbetje të përziera komunale për 12.01 t, thasë të shkyer të cementit për 7.5 t më shumë dhe mbetje nga demolimi për 40.4 t. Këto ndryshime në gjenerimin e mbetjeve tregojnë një ndryshim në volumin dhe natyrën e aktivitetit të ndërmarrjes midis dy periudhave. Përpjekjet për të zvogëluar gjenerimin e mbetjeve dhe për të promovuar ripërdorimin, riciklimin dhe kthimin e mbetjeve në resurse të reja janë të rëndësishme për të reduktuar ndikimin e ndotjes dhe për të përparuar drejt një ekonomie më të qëndrueshme dhe më të pastër.

Vlenë të theksohet se nga operatoret tjerë ekonomik të cilat posedojnë Leje të Integruar Mjedisore, nuk ka të dhëna të sakta të gjendjes mjedisore, si rezultat i mungesës se raportit vjetor të gjendjes mjedisore të tyre.

5.4. Format tjera të mjediseve të rrezikuara

Si forma të rrezikuara mjedisore vlerësohen edhe deponit sanitare te mbeturinave në Kosovë, në të cilën akoma nuk menaxhohen sipas standardeve të lejuara mjedisore. Kemi një përmirësim të gjendjes me mbeturinat ilegale, gjegjësisht në zvogëlimin e deponive ilegale në të cilën ky numër ka rënë 400 në të gjithë territorin e vendit.

Nuk kemi përmirësim të gjendjes mjedisore të deponive industriale, që janë një potencial ndotësish me metale të renda apo edhe shkarkime të ujrave acidike.

Mbeturinat e rrezikshme dhe kemikatet janë një problem tjetër i trashëguar nga vitet paraprak dhe akoma pa një trajtim paraprak të tyre. Depot me mbetjet e kimikateve monitorohen gjatë tërë vitit nga KFOR, FSK, dhe Inspektorati Mjedisore i MMPH-së.

6. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit

6.1. Zbatimi i strategjive dhe planeve mjedisore

Kosova në masë të kënaqshme e ka të zhvilluar kornizën strategjike dhe programore për mjedisin dhe sektorët e tij, mirëpo niveli i zbatimit është ende në shkallë të ulët. Në tabelën e mëposhtme janë prezantuar dokumentet kryesore strategjike dhe programore të sektorit të mjedisit dhe niveli i zbatimit të tyre.

Tabela 37: Niveli i zbatimit të strategjive dhe planeve të veprimit për sektorin e mjedisit

Strategjia/Plani	Periudha e vlefshmërisë	Statusi i dokumentit	Niveli i zbatimit
Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm Pjesë e strategjisë janë edhe Strategjia për Cilësinë e Ajrit dhe Strategjia për Biodiversitetin.	2023-2033	Në proces të hartimit	Në proces të hartimit - rishikimit
Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave	2021-2030	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Zbatohet në vazhdimësi
Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave	2021-2023	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Zbatohet në vazhdimësi
Strategjia dhe Plani Veprimit për Ndryshimet Klimatike për Kosovën	2018-2027	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës Vendimi, Nr. 05/90, datë 19.02.2019	Zbatimi në vazhdimësi
Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosoves – riahikimi për përiudhen 2023-2027 Plani Veprimit 2023-2025	2017-2036	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës Vendimi Nr.16/20 dt. 20.12.2017	Zbatimi në vazhdimësi
Plani Nacional Për Energji dhe Klimë i Republikës së Kosovës (Drafti i parë)	2023-2025	Në proces të hartimit	Në proces të hartimit
Plani Hapësinor i Kosovës - Strategjia për Zhvillimin Hapësinor të Kosovës (Rishikimi i planit 2010-2020+)	2023-2028	Në proces të rishikimit	Në proces të rishikimit
Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri"	2013-2022 (në proces të rishikimit)	Në proces të rishikimit	Pjesërisht
